



# D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Qershor 2008 • Viti XXV • Nr. 6 (165) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



**PSE KISHA I SHPALL DHE I NDERON SHENJTËRIT?**

FAQE 6-7

(Shkruan: DON JETON THAQI)



**PAPA PALI VI PAPA I EKUMENIZMIT, DIALOGUT DHE PAQES Me rastin e 30 vjetorit të vdekjes së Papës Palit VI (1978-2008)**

FAQE 11-12

(Shkruan: DON AGIM QERKINI)

**Lorenc Antoni - pionier i muzikës shqiptare në Kosovë (II)**

FAQE 18-19

(Shkruan: AKIL MARK KOÇI)



Shën Pali, manuskript i shek. IX. St. Gallen

## KËNDVËSHTRIM

# Viti i Shën Palit - Apostullit të Popujve

SHKRUAN: Don Fatmir KOLIQI

Me rastin e 2000-vjetorit të lindjes së Shën Palit, më 28 qershor në Vatikan ka filluar Viti i Shën Palit, i shpallur nga Shenjtëria e Tij Papa Benedikti XVI, gjatë të cilit Ati i Shenjtë dëshiron të përtellojë me tëpër rolin e madh të Apostullit të Popujve në historinë e shëlbimit dhe në Kishën sot. Ky Vit i shenjtë do të zgjasë prej 28 qershor 2008 deri më 28 qershor 2009.

“Një vit kushtuar Shën Palit, siç e ka shpjeguar edhe Papa, ka dy qëllime kryesore: a) ta njohim më mirë dhe ta bëjmë më të njohur Shën Palin, gjithë pasurinë e mësimëve të tij, ndonëse nganjëherë kjo mund të duket e vështirë, hermetike e pak e njohur – dhe b) t’i japim një ngjyrim ekumenik, duke u lutur e duke vepruar për ekumenizmin, d.m.th. për bashkimin. Shpesojmë, prandaj, se nga ky Vit Palian, do të përfitojë mbarë krishterimi”. Këtë e nënvizoi kardinali Andrea Kordero Lanca di Montexemolo, kryepriifti i bazilikës së Shën Palit jasht Mureve të Romës, me rastin e prezantimit të Vitit Palian të mbajtur në Radion e Vatikanit.

Të dielën, më 22 qershor, Viti jubilar i Shën Palit u përrua së pari në Tars të Turqisë, vendi i lindjes së Apostullit, me një meshtë të kremtuar nga kardinali Walter Kasper, kryetar i Këshillit Papnor për Nxitjen e bashkimit të të krishterëve, me ipeshkvijtë e Turqisë. Me këtë rast, ipeshkvijtë e Turqisë kanë botuar një letër baritore me titull: “Pali, dëshmitar dhe apostull i identitetit të krishterë”, në të cilën nënvizojnë nevojën e bashkimit në fe. Vendet e përfshira në kremtime do të jenë dy: Tarsi, ku është kërkuar përdorimi i kishës së lashtë kush-tuar Shën Palit, e cila sot është muze, dhe Antiochia, vend shtegtimi për besimtarët e të gjithë botës. Në Tars, vendlindja e Shën Palit, sot nuk ka të krishterë e as kisha, ndërsa në Antioki, në vendin ku për herë të parë nxënësit e Krishtit u quajtën të krishterë, mbijeton një bashkësi e vogël prej rreth dhjetë familjesh katolike e një numër më i madh greko-ortodoksësh të gjuhës arabe.

Në Romë Vitin e Shën Palit e ka përrua Papa Benedikti XVI në Bazilikën e Shën Palit jashtë Mureve, duke e ndezur flakën paliane. Papa atë u ka dorëzuar murgjve, të cilët do ta mbajnë të ndezur deri më 28 qershor 2009. Po ashtu Benedikti XVI hapi “Derën Paliane” simetrike në dyert e shenja të bazilikës, ku e ka kremtuar mbrëmjesoren së bashku me Patrikun ekumenik ortodoks Bartolomeu I dhe me një përfaqësues të Kishës Anglikane. Kjo ngjarje e madhe, shumë qartë filloi me ngjyra të theksuara ekumenike, sepse Shën Pali është apostull i të gjithë të krishterëve dhe krejt e arsyeshme që ky vit jubilar të jetë një shtysë e madhe për të kremtuar së bashku gjithë të krishterët.

### 1. Rëndësia e kremtimit jubilar – retrospektiva dhe prania e shpirtit palian në krishterimin e sotëm

Ky vit jubilar është i një rëndësie të madhe jo vetëm për të krishterët e Turqisë, të cilët mbi supet e tyre mbajnë një statut të rëndë të ngarkuar nga politika jo demokratike turke, por edhe për të gjithë të krishterët e botës, qofshin ata katolikë, ortodoksë, protestantë, anglikanë...



## Kontributi i klerit katolik Kongresit të Manastirit

FAQE 14-15

Shkruan: Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

## Intervista me Arbër Xhaferrin

**Shqiptarët janë ndër të parët evropianë që e pranuan krishterimin nga vetë apostujt**

FAQE 12-13



"Është një ngjarje e madhe shpirtërore e baritore, që mund të dubet të përforcojë në shpirtin e besimtarëve besimin në Jezu Krishtin, i cili vijon të na bëjë thirrje ta predikojmë e ta dëshmojmë Ungjillin e tij pa frikë e pa drojë", ka thënë Papa Benedikti XVI duke sintetizuar me këto fjalë vlerat e Vitit Palian. Po ky Papë qysh vitin e kaluar me rastin e festës së Shën Pjetrit dhe Palit ka theksuar rëndësinë e personit të Palit në përhapjen e ungjillit dhe unitetin e vëllezërve të krishterë: "Apostulli i Popujve, i nxitur posaçërisht për të përhapur Lajmin e Mirë në të katër anët e botës e shkriu tërë jetën për unitetin dhe harmoninë ndërmytet të gjithë të krishterëve".

Sot krishterimi ka nevojë gjithnjë për guximin, nxitjen, dashurinë dhe shpirtin flijues palian për ta dëshmuar Jezu Krishtin edhe në shekullin e lëvizjeve marramendëse mbarëbotërore, progresit teknologjik, manipulimeve gjenetike e "diktaturës së relativizmit" (Benedikti XVI); për të patur guximin e promovimit të vlerave ungjillore në jetën e përditshme. E ky kremtim jubilar mbarëkësishtar, në kujtim të nderueshëm e të shenjtë për Apostullin e Popujve, do të na fuqijojë në kërkimin e përvujtë të sinqertë të bashkimit të plotë të të gjitha gjymtyrëve të Korpit Mistic të Krishtit.

**a) "Pali dëshiron të flasë me ne sot" (Benedikti XVI)**

Gjatë gjithë kohës, kur po kremtohej solemniteti i Vitit Palian, me Papa Benediktin XVI bashkëkremtonte Patriku ekumenik Bartolomeu I, i cili kishte ardhur në Romë me ftesën e Papës enkas për të hapur këtë jubile. Kjo edhe një herë dëshmoi para gjithë Kishës dhe botës se Ati i Shenjtë e dëshiron këtë jubile të jetë rast takimi vëllazëror me shpirtin e Apostullit dhe vit i kërkimit të sinqertë për ta cuar në vend dëshirën e Mësuesit tonë Jezu Krishtit, *për të qenë një sikurse Ai është një me Atin gjellor.* Përshëndetja vëllazërore e Atit të Shenjtë drejtuar të gjitha kishave të pranishme Lindore dhe Perëndimore, ishte pikërisht përshëndetje paliane, biblike: "Hiri e paqja e Hyjit, Atit tonë dhe e Zotit tonë Jezu Krishtit, qofshin me ju të gjithë". Në mënyrë të posaçme iu drejtua Bartolomeu I me këto fjalë: "Vëllait të shumëdashur, Bartolomeu I, që sjell mes nesh praninë e bashkësitve të lashta të krishtera, të themeluara e të unguillezuara nga Shën Pali. E kapërcyem së bashku 'Derën Paliane' të kësaj bazilike zëmadhe të Shën Palit në rrugën Ostiense (vendi i martirizimit të apostullit), për t'i bapur udhën varëganit të gjatë të shtegtarëve që, këtu e në viset të tjera të botës,

do të përkuftojnë dymijëvjetorin e lindjes së Apostullit të madh të Popujve, Palit të Tarsit. Drita e Ungjillit dhe e fesë që përhapim me fjalën e me letrat e tij nga Qyteti i Shenjtë i Jerusalemit deri në kufijtë e Perandorisë Romake, arriti deri tek ne e vijon të japë frytë."

"Nuk jemi mblodhur këtu për të reflektuar mbi një histori të së kaluarës - shpjegoi Papa - Pali dëshiron të flasë me ne sot!". Prandaj nuk pyesim vetëm 'Kush ishte Shën Pali?', por 'Kush është Shën Pali?', çdëshiron t'i thotë secilit nga ne ai, që vijon të na kujtojë: "Jetoj në fenë e Birit të Hyjit, që më deshi e dhuoi vetëveten për mua". (Gal 2, 20). Feja e tij është dashuri për Jezu Krishtin, dashuri që e tronditi deri në thelb të zemrës dhe e shndërroi - nënvizoi Papa - e, në vijim, duke kujtuar se Pali paraqiti si njeri luftarak, që di ta vrinjë e llojllojë

shpirtin e Apostullit dhe vit i kërkimit të sinqertë për ta cuar në vend dëshirën e Mësuesit tonë Jezu Krishtit, për të qenë një sikurse Ai është një me Atin gjellor. Përshëndetja vëllazërore e Atit të Shenjtë drejtuar të gjitha kishave të pranishme Lindore dhe Perëndimore, ishte pikërisht përshëndetje paliane, biblike: "Hiri e paqja e Hyjit, Atit tonë dhe e Zotit tonë Jezu Krishtit, qofshin me ju të gjithë". Në mënyrë të posaçme iu drejtua Bartolomeu I me këto fjalë: "Vëllait të shumëdashur, Bartolomeu I, që sjell mes nesh praninë e bashkësitve të lashta të krishtera, të themeluara e të unguillezuara nga Shën Pali. E kapërcyem së bashku 'Derën Paliane' të kësaj bazilike zëmadhe të Shën Palit në rrugën Ostiense (vendi i martirizimit të apostullit), për t'i bapur udhën varëganit të gjatë të shtegtarëve që, këtu e në viset të tjera të botës,

Duke u ndalur gjatë tek ngjarja kryesore e jetës së Saulit të Tarsit, i cili kur takohet me Krishtin shndërrohet nga një persekutues i Jezusit, në ndjekësin më besnik të Tij, Papa rikujtoi pyetjen që i drejton Sauli Krishtit "Kush je ti, o Zot?", dhe përgjigjen "Unë jam Jezu, që ti po e persekuton", për të shpjeguar se me këtë përgjigje Jezusi bëhet një subjekt i vetëm me Kishën. Prej këndje Benedikti XVI theksoi se kjo përgjigje përmban gjithë doktrinën e Kishës si Korp i Krishtit, i cili nuk u ngjit në qiell, duke lënë këtu poshtë një aradhe ndjekësish, që ta çojë përpara çështjen e tij: "Kisha nuk është shoqatë, që promovon

saj; nuk mund të jetë shërbëtor i së vërtetës e, prej këndeje, as shërbëtor i fesë. Nuk ka dashuri, pa vuajtje - pa vuajtjen e mohimit të vetvetes, të shndërrimit, të spastrimit të vetvetes, për hir të lirisë. Atje ku nuk ka asgjë, për të cilën ia vlen të vuash, vetë jeta e humbet vlerën e vet. Eukaristia, qendër e jetës sonë të krishterë - bazohet mbi flijimin e Krishtit për ne, lind nga vuajtja e dashurisë, që arriti kulmin e vet në Kryq. Ne jetojmë nga kjo dashuri që na dhuobet".

**b) Kush është Shën Pali?**

Më tepër se jetëshkrimi i tij kronologjik, do të duhet të qitet në sipërfaqe personaliteti i tij i madh dhe unikat i jetës së krishterë në filllet e ritjes së Kishës, që Shën Pali ishte njëri ndër ata burra të fesë që e lëvroi ungjillin në të gjitha tokat e Mesdheut duke e mbjellur

ndaj Zotit e Kishës së tij, she-mbullin e njeriut që di të bashkëpunojë ngusht me njerëzimin dhe me kulturat e ndryshme. Pra një she-mbull i inkulturimit të shkëlqyer. Po ashtu, Ati i Shenjtë thekson mjedisin e jetës së Apostullit për ta kuptuar personin e tij drejt: Shën Palin nuk mund ta kuptojmë drejtë nëse nuk e vendosim në hapsirën, sa judaike aq edhe pagane. Rrethant shoqëroro-kulturore të dymijë vjetëve më parë - shpjegoi Papa - nuk ndryshonin shumë nga këto të sotmet. Gjëja kryesore, që duhet të kemi parasysh, për ta njohur më mirë Shën Palin, është lidhja ndërmjet mjedisit ku lindti e atij në të cilin jetoj më pas. Shën Pali i përkiste një kulturë të mirëpërcaktuar, asaj të popullit të Izraelit. Impenjimi i Palit - shtoi Papa - u favorizua nga dy faktorë: kultura helenistike dhe struktura politiko-administrative e perandorisë romake, që garantonte paqen e stabilitetin nga Britania në Egjipt. Vizioni universalistik, tipik për personalitetin e Shën Palit, shtytjen kryesore, natyrisht, e merr nga feja në Jezu Krishtin, sepse figura e të Ngjallurit tashmë e kapërcën çdo kufizim sektar. Por edhe situata kulturore e mjedisit i kohës së tij, nuk mund të mos ndikonin mbi rrugët që zgjedhi Apostulli: "Dikush e ka quajtur Palin 'njeri i tri kulturave', duke pasur parasysh prejardhjen e tij judaike, gjubën e tij greke e privilegjin e tij si 'civis romanus' (nënshtetas romak), siç e dëshmon edhe emri i tij me origjinë latine".

**2. Viti i Shën Palit tek shqiptarët!**

Viti Palian ka filluar edhe tek shqiptarët: në Kosovë fillimi i tij është hapur me meshe ditën e Shën Pjetrit dhe Palit në Gjakovë, ku pjesëmarrës ishin ipeshkvi ynë Imzot Dodë Gjergji dhe Imzot Hil Kabashi, administrator apostolik për Shqipërinë e Jugut. Në Shqipëri po ashtu Viti i Shën Palit ka filluar më 28 qershor me meshe në katedralen e Shën Palit në Tiranë.

Populli shqiptar ka një lidhje të veçantë me Shën Palin, pasi dimë se populli ynë u unguillezua nga ky apostull. Vetë Apotulli në letrën drejtuar Romakëve e pohon se që nga Jerusalemi e për qark në Ilirik e kam shpallur Lajmin e Mirë të Jezu Krishtit (khs. Rom 15, 19). Pikërisht për rëndësinë që ka Shën Pali për Kishën tonë dhe popullin shqiptar në përgjithësi, në trojet tona do të organizohen konferenca e takime lutjesh për nderim të Shën Palit. Kisha jonë në Kosovë edhe Konferenca Ispeshkvoe e Shqipërisë kanë formuar nga një komision kombëtar enkas për organizimin e veprimtarive kishtare gjatë këtij viti jubilar.



kësh-t u farën e krishterimit edhe në Europë, edhe në trojet tona shqiptëtare. Për të shkoqitur cilësi, tipare e mësimin e Shën Palit përmes së cilëve do të shpaleset karakteri i tij dhe feja e tij, po i nxjerrim disa mendime nga katekizmi i Benediktit XVI, që mbajtti në audiençën e të mërkuarës, të kushtuar pikërisht Apotullit të Popujve.

*një farë kauze. Ajo nuk ka të bëjë me një kauzë. Ka të bëjë me vetjen e Jezusit i cili, edhe si i Ngjallur, mbeti 'korp e gjak', që Krishti vijon të na e dhurojë e të bëjë nga ne Korpin e vet."* Duke kujtuar se Pali iush të vuajë shumë për Krishtin, se edhe vetë Krishti na shëllbon përmes mundimeve të veta, Benedikti XVI i lartoi një himn të vërtetë dashurisë për Krishtin, e vëmja që e bën jetën e njeriut të madhe, të pjekur, të vërtetë: "Në një botë, ku gënjeshtra është e fuqishme, e vërteta pagubet gjithnjë me vuajtje. Kush dëshiron t'i drejtojë vuajtjes, t'i rrijë larg, i rri larg vetë jetës e madhështisë së

# Festa e Shën Pjetrit e Palit, apostuj

Gjakovë, më 29. 06. 2008

Festa e Shën Pjetrit dhe e Shën Palit apostuj, është festë e kishës famullitare të famullisë së Gjakovës, të cilën besimtarët e rrethit të Gjakovës e festojnë me traditë. Natën e Shën Pjetrit e Shën Palit meshën në orën 18:00 në Gjakovë e ka kremtuar Don Tomë Karrica, famullitar i Pjetërshanit.

Ditën e Shën Pjetrit e Shën Palit, meshën solemne në orën 11 e kanë kremtuar 2 ipeshkvi: Mons. Hil Kabashi, ipeshkëv i Jugut të Shqipërisë, i cili edhe predikoi, dhe ipeshkvi i Kosovës, Mons. Dodë Gjergji. Së bashku me ta kanë kremtuar meshën edhe P. Anton Nua, famullitar dhe gardian i Gjakovës, dhe don Agim Qerkini, sekretar i ipeshkëvit.

Mons. Hil Kabashi në pre-

dikimin e vet e theksoi rolin e Shën Pjetrit, të parit të apostujve, dhe Shën Palit, misionarit më të madh të krishterimit, duke theksuar veçanërisht se me këtë festë fillon Viti i Shën Palit apostull – kremtimi i 2000-vjetorit të lindjes së tij.

Në mbarim të meshës edhe ipeshkvi ynë, Mons. Dodë Gjergji, e përshëndeti popullin dhe uroi që ky vit, i kushtuar Shën Palit, të jetë i frytshëm për të gjithë besimtarët tanë dhe për mbarë Kishën e Krishtit. Të dy ipeshkëvijtë e kanë shprehur dëshirën që gjatë këtij viti të Shën Palit të përfundojë ndërtimi i kishës sonë famullitare, që po vonohet për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Dhashtë Zoti të realizohet edhe kjo dëshirë e barinjve tanë shpirtërorë!  
(P. Lovro Gavran)



Mesha e festës së Shën Pjetrit e Palit në Gjakovë

## Takimi i Kishës sonë me ecjen neokatekumenale



Pamje nga takimi me neokatekumenët

Më 28 qershor në gjimnazin M.Loyola në pjesën e transitit të Prizrenit, u mbajt takimi i parë me neokatekumenët nga Shqipëria. Takimi u bë me ftesën e Imzot Dodë Gjergjit, ipeshkëv të Kosovës, me pjesëmarrje të klerit dhe bashkësive rregullare tek ne. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i përvojave fetare

dhe i "Ecjes neokatekumenale". Ky takim u mbajt natën e festës së kryeapostujve Shën Pjetrit dhe Palit, si dhe në fillimin e Vitit Palian, të cilin e ka shpallur Papa Benedikti XVI.

Në fjalën e rastit Imzot Dodë Gjergji, pas përshëndetjes vëllazërore meshtarëve dhe shekullarëve nga viset e ndryshme të

Shqipërisë, ndër të tjera tha: "Sot për ne është një ditë e veçantë e përtëritjes shpirtërore, me meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare tona nga mbarë Kosova për t'u begatuar me përvojat dhe dëshmitë tuaja të fesë. Ju falënderoj për këtë mund e dhuratë, sidomos tani kur po hyjmë në Vitin e Shën Palit, unguillëzuesit dhe

apostullit të madh të popujve, të mbarë njerëzimit...".

Pastaj takimi vazhdoi me paraqitjen e bashkësisë neokatekumenale. Pas paraqitjes ishte edhe një pyetësor që mundësoi një meditim dhe shkëmbim mendimesh dhe përvojash të përbashkëta, në lidhje me sfidat e sotme që i ka kisha në botë dhe që mund të ishin nesër edhe për kishën tonë ndër shqiptarë, për lëvizjet e reja kishtare në botë e në veçanti për neokatekumenët, kurse fare në fund, sa është e nevojshme një lëvizje e tillë në Kosovë. Përgjigjet ishin të ndryshme por që kishin buruar nga zemra e fesë dhe nga përvoja e punës pastorale.

Pas dite u zhvillua shërbesa pendestare dhe Mesha e shenjtë.

### Kush janë neokatekumenalët sot në Kishë dhe në botë?

Lëvizja neokatekumenale ka lindur në Spanjë në gjysmën e shek. XX nga piktori Kiko Arguëlle dhe Carmen Hernandos. Qëllim kryesor ajo ka "ecjen në fe"

nëpërmjet rizbulimit të pagëzimit, rishqyrtimit dhe medimit të Fjalës së Zotit, Biblës dhe jetës sakramentale, në veçanti rëfimit dhe eucaristisë.

Mënyrat e ecjes neokatekumenale janë: shpallja e parë apo kerygma, thelbi i fesë, formimi nëpërmjet uratës dhe medimit të përditshëm deri tek jetësimi, tek përvoja se Zoti është vërtetë Ati ynë.

Sot neokatekumenët në botë janë të pranishëm në afro 900 ipeshkvi, në 6000 famull dhe në afro 40.000 bashkësi bazike. Këtë lëvizje kishtare përfundimshme e ka aprovuar Vatikani më 13 qershor 2008, pas 5 viteve "ad experimentum" si lëvizje e Shpirtit të Shenjtë me qëllim të gjallërimit të fesë, bashkësive fetare dhe dëshmisë së krishterë. Synim kryesor ka rritjen e vetëdijes dhe përcaktimit, pjesëmarrjes në jetën e krishterë, duke u nisur prej rizbulimit dhe jetësimi të pagëzimit, shijimit të Fjalës së Zotit dhe kremtimit të sakramenteve. (Don Lush Gjergji)

## Festa e Shën Antonit të Padovës

Gjakovë, e enjte, më 12 qershor 2008

Sikur çdo vit, po ashtu edhe sivjet Natën e festës së Shën Antonit të Padovës, më 12 qershor 2008 në orën 18, në oborrin e kishës së Shën Antonit në Gjakovë u bashkua një shumicë e madhe e besimtarëve të famullisë sonë, si edhe e shumë famullive të tjera të Kosovës. Meshën e kremtoi don Lenc Sopi, famullitar i Klinës, së bashku me pesë meshtarë të tjerë: p. Anton Nua, p. Ndue Kajtazi, don Franë Kola, don Kelmend Spaqi dhe don Kolë Thaqi.

Koha ishte shumë e bukur. Oborri

ishte plot e përplot me besimtarë, të cilët me vëmendje e kanë përcjellë predikimin e don Lencit. Më shumë se 2.500 besimtarë kanë marrë Kungimin e shenjtë vetëm në atë Meshë!

Ditën e Shën Antonit të Padovës, të premtën, më 13 qershor 2008, herët në mëngjes retë ishin shndritur me dritën e fortë të Diellit që po lindte... Shpejt pastaj ra shiu aq i fortë, sa që u detyruam që meshën në orën 7 ta kremtonim në kishë. Meshën e kremtoi don Franë Kola, së bashku me P. Ambrozio dhe P. Lorençin.

Pas meshës së parë koha shumë shpejt u përmirësua, kështu që meshët në orën 9 dhe 11 i kremtuam pa kurrfarë problemi përjashta, në oborr të kishës së Shën Antonit. Meshën e orën 9 e kremtoi p. Ndue Kajtazi.

Kremtuesi i meshës solemne në orën 11, ishte P. Prelë Gjurarshaj, OFM, frat i Tuzit dhe profesor i teologjisë në Seminarin e Shkodrës. Së bashku me të kanë kremtuar edhe p. Anton Nua, p. Ambroz Ukaj, don Tomë Karrica, don Rrok Gjonlleshaj dhe don Jeton Thaqi.

Besimtarët, si çdo herë për festë, e kishin stërbushur oborrin... Në predikimin e vet p. Prela e theksoi nevojën

e besimit të plotë në Zotin tonë Jezu Krishtin, si kusht të shëlbimit dhe të shenjtëritimit – e ky besim dëshmohej me dashurinë vepruese ndaj Zotit dhe ndaj të afërimit.

P. Prela porositi se lutjet dhe kërkesat e të mirave të përkohshme të kësaj bote – siç janë shëndeti, pasuria, nafaka (fati), sukcesi në ndonjë punë etj. – nuk janë dëshmi feje të vërtetë në Krishtin Zot dhe Shëlbues, i cili na ofron jetën dhe lumturinë e amshuar. Feja e vërtetë dëshmohej vetëm me dorëzimin e plotë në vullnetin e Zotit, Atit tonë të mirë qiellor në të gjitha rrethanat e jetës. (P. Lovro Gavran)

Kisha Katolike në festën e pajtorit të saj  
Shën Gjon Pagëzuesin kremtoi edhe ditën e themelimit të saj

# Tempulli i rritjes shpirtërore dhe i mbrojtjes së kulturës kombëtare

## Tradita që po vazhdon

Në qershorin përcëllues, Nshetëgimet e gjata të njerëzve nga Lugu i Drinit, Dukagjini dhe pjesët tjera të Klinës dhe Kosovës, ishin drejtuar në drejtim të kishës katolike "Shën Gjon Pagëzuesi" në Zllakuqan për ta kremtuar Ditën e Shën Gjon Pagëzuesit, pajtorit të këtij tempulli të fesë dhe të kulturës shqiptare. Kësaj kremteje për tri ditë radhazi para ditës së Shën Gjonit i priu edhe një seminar shpirtëror të mbajtur nga dr. dom Prekë Lazri. Pra, që nga mbremja e datës 17 qershor e deri në mëngjesin e datës 22, në Mesheën e orës 9, u mbajt Seminarin për ungjillëzimin e popullit. Gjatë këtyre ditëve u mbajtën shumë ligjëratat, predikime dhe shpjegime të bazuara në Ungjill dhe në shpjegimin e traditës apostolike. Numri i madh i pjesëmarrësve tregoi më së miri nevojën e seminarëve të kësaj lloji.

Si rëndom, në këtë famulli me shumë traditë, u bë një festë madhështore në të gjitha aspektet. Numri i madh i meshtarëve dhe i besimtarëve rriti dinjitetin e kësaj famullie. Meshën solemne e udhëhoqi Dr. Don Shan Zefi, i cili më këtë rast kremtimit mbajti homilinë (predikimin) solemne të rastit, me ç'rast ceku rolin e Kishës gjatë shumë dekadave në Kosovë dhe kontributin e saj të madh në arritjen e pavarësisë së Kosovës. Po ashtu për besimtarët dha një porosi të thukët nga jeta e Shën Gjonit, duke bërë me dije shembëllyrën e jetës së tij e cila do të na ndihmonte në rrugëtimin tonë kah amshimi në Hyjin.

## Hapja e tempullit të fesë dhe shkollës shqipe

Rruga historike e kishës katolike "Shën Gjon Pagëzuesi" në Zllakuqan është kurorëzim i përpjekjeve të mëhershme e fretërve dhe klerit tonë katolik në përgjithësi, për ta hapur këtë tempull të Zotit dhe të kulturës shqiptare. Këto përpjekje të këtyre etërve tanë të kombit u kurorëzuan në vitin 1897 kur në këtë fshat erdhi për të shër-

byer frati dhe atdhetari i devotshëm Atë Shtjefën Gjeçovi, i ndihmuar nga dy fretërit të tjerë, Atë Engjëll Palaj dhe Atë Lorenc Mazreku, ku me këtë rast në lokalitete e këtij tempulli ata hapën edhe shkollën e parë shqipe në këtë fshat, që ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për këtë mjedis dhe më gjerë. Në këtë çerdhe fetare, arsimore e kulturore mësimet i vijonin fëmijët e këtij lokaliteti dhe më gjerë, pa dallim konfesionit. Edhe pas shkuarjes së Atë Gjeçovit më 1899, u tha me këtë rast, kleri i cili shërbeu këtu vazhdimisht bëri përpjekje, edhe përkundër pengesave të regjimeve, që fëmijëve të cilët kishin nevojë për dije edhe arsim kombëtar, më shumë se kurdoherë më parë, t'ua mësojë shkrimin dhe këndimin shqip, historinë kombëtare etj.

Pjesëmarrësit në festën e Shën Gjonit në Zllakuqan



## Reprezaljet dhe rezistenca e popullatës shqiptare

Edhe viti 1909, u theksua se shënon një datë të rëndësishme historike për këtë trevë dhe më gjerë, kur në marsin e këtij viti frati i kësaj kishë, i cili edhe ishte mik i patriotit Isa Boletini, në bashkëpunim me maritirët të shquar të asaj kohe, Zef Gjidođen dhe Pjetër Qelin, bashkuan burrat dhe trimat të

kësaj ane prej katërqind personash të besimit katolik, dhe iu bashkëngjiten aradheve të Isa Boletinit kundër pushtetit otoman. Po ashtu, gjatë Luftës Ballkanike edhe treva e Lugut të Drinit ka hequr të zitë e ullirit nga pushteti i atëhershëm serbomalazez, i cili bënte terror të përgjakshëm në këtë lokalitet me qëllim që ta ndërrojnë fenë dhe të sllavizoheshin shqiptarët. Gjatë sundimit të Jugosllavisë së Vjetër, populli shqiptar ishte i shtypur. Gjatë gjithë kohës së sundimit të saj qeveria e atëhershme jugosllave merrete masat më drastike për t'i zhdukur shqiptarët nga trojet e tyre shekullore. Kulmi i një pushtimi të egër u arrit në vitin 1919 kur ky pushtet dogji në tërësi Lugun e Drinit. Me këtë rast, popullata e kësaj ane ishte e detyruar që t'i lëshonte

timi i politikës së kolonizimit dhe i reformës agrare. Duke u ballafaquar me këtë situatë të rënd, u tha ndër të tjera, e cila kishte përshirë këtë popullatë, Dom Gjon Bisaku, një prift atdhetar, bashkoi burrat e nderuar më me ndikim të kësaj ane dhe në vitin 1925 shkuan në Vatikan ku u pritën nga Ati i Shenjtë. Ky delegacion qarqeve të Vatikanit dhe të shteteve tjera evropiane iu kishin dërguar disa herë relacione duke i njoftuar me gjendje e rëndë të kësaj popullate. Dom Gjon Bisaku, në vitin 1930, së bashku me Dom Shtjefën Kurtin dhe Dom Luigj Gashin, i dërguan Lidhjes së Kombeve në Gjenevë në Memorandum prej rreth dyzet faqesh për ta bërë këtë organizatë ndërkombëtare me dije për vrasjen e fratit atdhetar atë Shtjefën Gjeçovi, nga

## Imzot Mark Sopi për dy dekada udhëhoqi këtë tempull shpirtëror e kulturor

Në vitin 1974 në këtë kishë erdhi për të shërbyer dom Mark Sopi, i cili si bari në këtë vend shërbeu për afro dy dekada. Puna dhe veprimtaria baritore dhe atdhetare e dom Mark Sopi, i cili vdiq kohë më parë, si ipeshkëv i Ipeshkvisë së Kosovës, ishte e gjithanshme dhe shumë e frytshme. Ai u angazhua në shumë veprimtari atdhetare që i kërkonte koha, si në pajtimin e gjaqeve, etj. Me angazhimi dhe kontributin e tij popullata e Zllakuqanit në vitin 1982 arriti të takohet me humanisten më të madhe të shekullit të kaluar Nënë Terezën.

Edhe gjatë luftës së fundit kjo vatër e fesë dhe e kulturës kombëtare dha një kontribut të çmuar në strehimin dhe sigurimin e ushqimit, të veshmbathjeve dhe të gjerave të tjera për popullatën e zhvendosur me dhunë nga trojet e tyre shumëshekullore. Kleri i këtushëm në krye me do Lush Sopin dhe motrat e nderit, gjatë kësaj kohe nuk kursyen asgjë nga vetja, në mënyrë që kjo popullatë që vuante shumë dhe ishte e dëbuar nga shtëpitë e tyre, të ndihmohej.

Kështu që, kur përkujtojmë qëndresën e këtij populli në këto anë, nuk mund t'u shmangeni edhe përpjekjeve të pareshura që ka bërë gjatë edhe kleri katolik shqiptar i cili ka shërbyer këtu, ku afër dhjetë prej tyre për shkak të veprimtarive të tyre fetare janë persekutuar dhe vrarë nga regjimi serb dhe ai komunist, si atë Shtjefën Gjeçovi, atë Lorenc Mazreku atë Engjëll Palaj, atë Klement Miraj, atë Luigj Palaj, atë Marjan Prael, dom Pjetër Berisha e shumë të tjerë. S'do mend se secili nga këto figura meritojnë të ndriçohen në mënyrë të veçantë.

Kështu që, kjo vatër e shpirtërore, kulturore, arsimore dhe kombëtare gjatë rrugës së saj historike ka dhënë një kontribut ta madh për popullin katolik dhe atë shqiptar në përgjithësi.

Mikel Gojani

vatrat e veta dhe të strehohej në vise të tjera të Kosovës. Më tej, u theksua (në gjatë ditëve të seminarit) se gjatë këtyre viteve gjendja e popullatës shqiptare të kësaj ane sa vinte e keqësohet gjithnjë e më shumë. Masat e shtypjes shoqërore dhe planet e projektuara nga qarqet e caktuara të cilat realizoheshin me tërë brutalitetin e tyre. Në këtë kuadër hynte edhe zba-

qarqet e caktuara të shërbimit serb, po ashtu duke e njohur këtë organizatë për shkeljen e të drejtave njerëzore e kombëtare nga ana e pushtetit të atëhershëm. Gjatë rrugës së saj historike, ky tempull shpirtëror e i kulturës shqiptare bashkë me popullatën kaloi rrugëtim të kalvarshëm, mirëpo gjithëherë me devotshmëri duke i sfiduar situatat.

Me rastin e përmbylljes së Kongresit Ndërkombëtar Eukaristik në Kanada

# Eukaristia, burim i jetës së krishterë

*Eukaristia është pasuria jonë më e çmueshme, e cila na bën t'i shijojmë qysh tashti të mirat e amshueshme. Eukaristia përfshinë të gjitha misteret e shëlbimit tonë, është burimi dhe kulmi i veprimtimit dhe i jetës së Kishës Jezu Krishti realisht i pranishëm në kungim na fton të angazhohemi me të gjithë vëllezërit tanë për t'i përballuar sfidat dhe për ta bërë botën një vend në të cilin mund të jetohet mirë dhe në paqe me të gjithë. Eukaristia na fton ta respektojmë jetën që nga ngjizja e deri në vdekjen e natyrshme, na fton që mos ta ndajmë botën në të pasur dhe në të varfër, por të angazhohemi që të jemi një me të drejta dhe dinjitet të barabartë. Papa Benedikti XVI*

■ SHKRUAN:  
Don Anton UKAJ

“Eukaristia është një thirrje në dashuri në situatë konkrete të jetës së përditshme, e cila duhet të stimulojë dhe të modifikojë stilin dhe veprimin e jetës së njeriut”, ka theksuar kardinali Francis Arinze, prefekt i Kongregatës për kultin hyjnor dhe për disiplinën e sakramenteve, në predikimin e mbajtur gjatë Kongresit eukaristik internacional.

Arqipeshkvi i vendit Mark Oullet, në fjalimin e tij mes tjerash tha: “Ne të cilët e celebruam Bukën e qiellit, dhuratën e Zotit për jetën e botës, nuk mund të ushqehemi nga kjo bukë e jetës pa u preokupuar për fatin e shumë të uriturve nëpër vende të ndryshme të botës”.

Arqipeshkvi kanadez ka dashur të theksojë krizën internationale ushqimore ku shumë vende të botës kanë vështirësi t'i garantojnë gjërat elementare për arsye të çmimeve shumë të larta. Çmimet e patolerueshme i lënë të varfrit në një situatë të papërbalueshme dhe është i nevojshëm një veprim i menjëhershëm i qeverive dhe i Shteteve të Bashkuara, për t'u ndihmuar të uriturve dhe për të vendosur një ekuilibër në prodhimin elementar dhe në shkëmbimin komercial. Kardinali Oullet ka kërkuar një angazhim të përbashkët për një shpërndarje të drejtë të gjërave elementare për jetesë, në mënyrë që të varfrit mos të mënjanohej nga sofrat

Adhurimi me të Shenjtueshin Sakrament gjatë kongresit eukaristik në Kanada



përbashkët e të mirave për jetesë. “Duhet t'i themi 'po' – shton Kardinali – bashkëndarjes së bukës së përditshme me të gjithë të uriturit, duke i kërkuar Shpirtit të Shenjtë ta ripërtërijë besimin tonë ndaj Eukaristisë, dhuratës më të çmueshme të Zotit”.

Në javën e punimeve, të hapur të dielën më 15 qershor, kanë marrë pjesë afër 15 mijë besimtarë, 50 kardinalë, më shumë se 100 ipeshkvi dhe qindra meshtarë nga kontinentet të ndryshme, të cilët edhe prezantuan realitetet e ndryshme të fesë. Turma e madhe e besimtarëve, përshpirtëria e tyre, lutja, kënga, adhurimi ... e shndërruan qytetin kanadez në një qytet eukaristik. Në këtë Kongres Eukaristik u zhvilluan aktivitetet të ndryshme, pikërisht për ta rikujtuar trashëgiminë shpirtërore të transmetuar nga misionarët të ndryshëm dhe kështu këto aktivitetet shndërroheshin në një ftesë për të rinjtë dhe për të gjithë njerëzit vullnetmirë që të shndë-

rrohen në dëshmitarë të Ungjillit, duke i ndjekur gjurmët e Krishtit. Mes të tjerash, ipeshkvi ndihmës i Quebec-it, ka bekuar një kryq, aty para Kishës së Shën Mikelit të Sillery, që do të mbetet në kujtim të përvjetorit të 400-të të qytetit, të 49-it Kongres Eukaristik Ndërkombëtar. Kongresistët dëshmojnë të kenë përjetuar një përvojë bashkimi vëllazëror dhe një shkëmbim përvojash kulturore.

Thuhet se procesioni eukaristik që u mbajt gjatë këtij Kongresi Eukaristik, ishte i gjatë më shumë se 5 kilometra me besimtarë dhe të gjitha rrugët ishin përplot me njerëz të ardhur nga të katër anët e botës. Një fakt tjetër, që është bartë nga mass-mediet, është pjesëmarrja e madhe e besimtarëve në sakramentin e rëfimit, ku thuhet se besimtarët pritnin me orë e orë vetëm e vetëm që ta pranonin faljen e Zotit përmes meshtarit në sakramentin e pajtimit.

Papa Benedikti XVI, në pamu-

ndësi për të marrë pjesë në këtë eveniment të Kishës universale, në meshën përmbylëse të Kongresit Eukaristik, të udhëhequr nga delegati i tij personal kardinali Jozef Tomko; nga Vatikan i lidh me qytetin kanadez, ku përmes njetëve audio-vizive e bëri predikimin përmbyllës të këtij eventi-menti të Kishës katolike. Papa, si gjithmonë, me një thjeshtësi dhe urti unguillorë, mes tjerash tha: “Eukaristia është pasuria jonë më e çmueshme, e cila na bën t'i shijojmë qysh tashti të mirat e amshueshme. Eukaristia përfshinë të gjitha misteret e shëlbimit tonë, është burimi dhe kulmi i veprimtimit dhe i jetës së Kishës. Pikërisht për këtë gjë është e rëndësishme që barinjët dhe besimtarët të angazhohen qëndrueshmërisht në thellimin e këtij sakramenti, në mënyrë që të konsolidohet feja dhe të kryhet me mirë misioni ynë në botë. Pjesëmarrja në Eukaristi na bashkon me të parët tanë, me shenjtërit dhe shenjtëreshat e Kishës, dhe kështu na bën të kuptojmë se kungimi është shprehja më e mirë e dashurisë së Zotit për njerëzimin. Jezu Krishti realisht i pranishëm në kungim na fton të angazhohemi me të gjithë vëllezërit tanë për t'i përballuar sfidat dhe për ta bërë botën një vend në të cilin mund të jetohet mirë dhe në paqe me të gjithë. Eukaristia na fton ta respektojmë jetën që nga ngjizja e deri në vdekjen e natyrshme, na fton që mos ta ndajmë botën në të pasur dhe në të varfër, por të angazhohemi që të jemi një me të drejta dhe dinjitet të barabartë”.

Papa uroi që ky Kongres Eukaristik të shndërrohet në thirrje për të gjithë besimtarët, në mënyrë që të angazhohen për një ripërtrirje të mesimit eukaristik. Në mënyrë të posaçme u bëri ftesë meshtarëve që t'ia japin nderimin dhe adhurimin e duhur Eukaristisë. Riti eukaristik dhe adhurimi i të Shenjtushmit Sakrament – ka theksuar papa – i lejon njeriut të futet në bashkim me Jezusin, dhe përmes Tij me Trininë Shenjte, në mënyrë që të shndërrohet në atë që marrim dhe për të jetuar në bashkim me Kishën.

“Mundohuni të gjithë ju – ishte urimi i papës – të bëheni gjithnjë e më të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të Eukaristisë të të dielës, sepse e diela, dita e parë e javës, është dita në të cilën e nderojmë Krishtin, është dita në të cilën mbushim me fuqi për ta jetuar për çdo ditë dhuratën e Zotit”.

Në përfundim të predikimit, para se të shpallte që Kongresi i ardhshëm Eukaristik Ndërkombëtar do të mbahet në Dublin, në Irlandë, në vitin 2012, papa ka rikujtuar popullin e Zotit se duhet lutur të Zotin e të korrave të dërgojnë punëtorë në të korrat e veta.

## Papa Benedikti XVI apelon tek pjesëmarrësit e G8 në Hokaido-Toiako që të kenë në agjendë varfërinë e popujve të botës

Të dielën e kaluar, Papa Benedikti XVI, gjatë lutjes së Engjëllit të Tenzot, ka bërë një thirrje të fuqishme drejtuar pjesëmarrësve në takimin e rangut të lartë të G8 të mbajtur në Japoni, në ujdheshën Hokaido-Toiako. G8 – tetë shtetet më të industrializuara të botës dhe Rusia u takuan për të biseduar për shumë çështje aktuale në botë, siç janë: rritja e çmimeve të ushqimit, naftës, varfëria dhe krizat në Zimbabve... Një çështje që u dëgjua të ketë qenë temë

diskutimi ishte edhe Republika e Kosovës, përkatësisht kërkimi i mundësive për njohjen më të madhe nga shtetet që ende hezitojnë për ta pranuar shtetin më të ri në botë.

Papa Benedikti XVI ka bërë disa herë thirrje Politikës ndërkombëtare dhe Institucioneve të tyre që të luftojnë varfërinë e madhe në botë. Takimet e niveleve të larta ndërkombëtare të shteteve të industrializuara janë raste të vulltshme për të patur në tavolinë çështjen e var-

fërisë. Pasi të hënën ka filluar samiti G8, Ati i Shenjtë ka ftuar të pranishmit që të zotohen për të marrë masat e nevojshme për zbutur shuplakën e varfërisë, të urisë, sëmundjeve, analfabetizimit....

“U drejtohem pjesëmarrësve në takimin Hokaido – Toiako, që në qendër të vendimeve të tyre të vendë nevojat e popullsive më të ligshhta e më të varfra, të cilat vijojnë të varfërohen edhe më tutje, për shkak të spekulimeve, të trazirave financiare e të pasojave të tyre negative mbi çmimet e

ushqimeve dhe energjisë. Uroj që bujaria dhe largpamësia t'u ndihmojnë të marrin vendime që të sigurojnë rifillimin e procesit të drejtë të zhvillimit të përgjithshëm, që mbron dinjitetin njerëzor.” – ishte ftesa e Shenjtërisë së Tij Benedikti XVI.

Ky apel i Atit të Shenjtë si duket është marrë seriozisht dhe, siç lajmëron mediat e shumta ndërkombëtare, burrëshetëtarit e G8 kanë miratuar një fond disa milionësh për uljen e varfërisë në botë. (D)

# Pse Kisha i shpall dhe i nderon shenjtërit?

■ SHKRUAN:  
Don Jeton THAQI

## Pak histori

Sipas disa shkrimtarëve, origjina e lumturimit (*beatifikimit*) dhe e shenjtërimit (*kanonizimit*) në Kishën Katolike, rrjedh prej traditës apo shprehjes shumë antike të paganizmit *apoteosi*, që do të thotë deifikim, ngritje e disa personave (*personaliteteve*) në rangun e hyjnive, apo në emërtimin e disa heronjve apo prijësve si shpërblim për guximin e tyre apo për meritat e tjera eventuale. Si do qoftë, ky është

një fenomen ngushtë i lidhur me kultin e të vdekurve në historinë e të gjithë popujve primitivë.

Porse, në veprën e tij klasike *De servorum Dei beatificatione et beatorum canonizatione* Papa Benedikti XIV (1675-1758) ekzaminon, shqyrton dhe menjëherë refuzon këtë vizion. *Apoteosi* i përkiste sidomos familjeve aristokrate, me qellim që shpesh herë të mbulonin hidhërimin

dhe mendimet jo të mira që ekzistonin për këtë klasë shoqërore.

Kanonizimi apo shenjtërimi në Kishën Katolike është krejtësisht diçka tjetër. Kisha kanonizon, i ngrit në altar ata të cilët me jetë janë të shënuar në ushtrimin e virtyeteve heroike, dhe kjo gjë bëhet vetëm pasi që një gjë e tillë është e pranuar nga një reputacion i gjerë dhe me argumente të vlefshme. Dallimi kryesor qëndron sidomos në faktin që Kisha tek shenjtërit nuk sheh asgjë tjetër përveçse miqësinë, dashurinë ndaj Zotit,

të shprehur në shërbim dhe përkushtim ndaj vëllezërve. Kisha nuk pretendon t'i shpallë shenjtërit hyjni (*kbs. Eusebio Emiseno, sermone de S. ROM. M; Agostini, De civitate Dei XXII, X; Cirilli i Aleksandrisë, Contra Jul., lib. VI; Cipriani, De Exhortat. martyr.; Conc. Nic., II, act. 3*).

Origjina e vërtetë e kanonizimit duhet kërkuar në doktrinën katolike të kultit (*cultus*), thirrjes dhe ndërmjetësisë së shenjtërve. Ashtu sikur na mëson edhe Shën Augustini (*Quaest. in Heptateuch., lib. II, n. 94; Contra Faustum, lib. XX, xxi*), të krishterët, apo më mirë - përkatësisht katolikët, për deri sa i japin vetëm Hyjit adhurimin dhe nderimin e vërtetë, ata i nderojnë edhe shenjtërit për dhuratat hyjnore apo mbinatyrore që ua kanë mundësuar atyre jetën e pasosur, dhe nëpërmjet të të cilave mbretërojnë së bashku me Zotin, si bijë të zgjedhur dhe shërbëtorë besnikë të Tij. Me fjalë të tjera, katolikët e nderojnë Zotin tek shenjtërit e Tij si dhurues të dashur të shumë dhuratave mbinatyrore. Ekzistojnë emërtime që e përcaktojnë kultin ndaj Zotit të vetëm, ndaj Zojës së Bekuar dhe ndaj shenjtërve: *latreia* quhet kur adhurimi i vërtetë i jepet vetëm Zotit, *hyperdouleja* - nderimi ndaj Zojës së Bekuar dhe *douleja* - nderimi ndaj shenjtërve. Kisha i ngrit në altar vetëm Zotit (*Aug., Contra Faustum, XX, xxi, 21; cf. De Civit. Dei, XXII, ii*), edhe pse i ngrit në nder dhe përkujtim të shenjtërve dhe martirëve. Ekziston edhe një fundament biblik i gjithë këtij kultit që na grish për t'i nderuar edhe engjëjt, të cilët janë në përngjasimin e Hyjit deri sa ata janë pjesë e miqësisë dhe dashurisë së Tij (*kbs. Ex 23, 20; Jz 13; Dan 8, 15; 10, 4; Lk 2, 9; Vap, 12, 7; 11; 7, 1; Mateut 8, 10; etj*). Edhe vetë Shën Pali i lut vëllezërit që ta ndihmojnë me lutjet e tyre (*Rom 15, 30; 2 Kor 1, 11; Kol 4, 3; Ef 6, 18.19*) dhe të besojnë me qëndrueshmëri se mund të arrihet ndihma dhe mbështetja nga ndërmjetësia e shenjtërve. Nëse është e mundur të luten ata që jetojnë në tokë, pse nuk mund të luten dhe të kërkohet ndihma dhe ndërmjetësia e atyre që jetojnë në qiell.

Ndoshta, dyshimi më i madh në nderimin dhe ndërmjetësinë e shenjtërve, është se ndërmjetësuesi i vetëm ndaj Hyjit dhe njeriut është Jezu Krishti. Por Ai është ndërmjetësuesi i vetëm në cilësinë e Tij si Shëlbues yni i përbashkët; Ai nuk është vetëm një ndërmjetësues apo avokat, ose një ndërmjetësues vetëm nëpërmjet lutjes. Në pjesën e njëmbëdhjetë të Koncilit të Kalcendonës (451) nga etërit shqiptohet këto fjalë: "Flaviani jeton pas vdekjes! U lutë ai për ne!". Nëse pranohet kjo doktrinë e kultit të shenjtërve, për të cilat ekzistojnë shumë prova në shkrimet e etërve të Kishës dhe në kremtimet liturgjike të kishës lindore dhe të asaj perëndimore; nuk duhet asesi të befasohejmë për mundin e madh që kisha e tregoi në përmbledhjen dhe në të shkruarit e të gjitha atyre vuajtjeve të martirëve të parë, duke i përcjellë nga një bashkësi në një bashkësi tjetër për të nxitur nderimin e martirëve. Një polemikë tjetër shumë me rëndësi në këtë drejtim, ekziston edhe në të drejtën ekskluzive për të bërë autorizimin që një shenjt apo shenjtëreshë të nderohet dhe të ngrihet në këtë piedestal. Pa hyrë në detaje për ta mbi çështjen, nëse në shekujt e parë këto vendime merreshin nga ipeshkvijtë lokalë dhe nderimi bëhej nga kishat lokale, më vonë u vendos që shenjtërimi dhe beatifikimi të vendosen në Koncilet ekumenike, deri tek Papa Urbani VII, i cili në vitin 1634 publikoi një bullë me të cilën i dha fund krejt këtij diskutimi duke ia lënë ekskluzivisht Selisë së Shenjtë, jo vetëm të drejtën antike të kanonizimit, por edhe atë të beatifikimit.

## Domethënia terminologjike

Termi apo fjala *shenjt* mund të themi që rrjedh prej fjalës semitike *qâdes*, gjë e shenjtë, shenjtëri, me kuptimin "pres, ndaj" dhe na çon drejt një ideje me ndarjen prej profanës (*kbs. Xavier Leon-Dufour, Fjalori i teologjisë biblike, fq. 1267*). Origjinën e kësaj fjale mund ta gjejmë edhe prej fjalës latine *sancire*, që do të thotë i padhunueshëm, i paprekshëm,



Pikturë e Shën Pjetrit e Palit në kishën filiale në Poterq, familja e Glaviçes

“ Kisha kanonizon, i ngrit në altar ata të cilët me jetë janë të shënuar në ushtrimin e virtyteve heroike, dhe kjo gjë bëhet vetëm pasi që një gjë e tillë është e pranuar nga një reputacion i gjerë dhe me argumente të vlefshme. Kisha tek shenjtërit nuk sheh asgjë tjetër përveçse miqësinë, dashurinë ndaj Zotit, të shprehur në shërbim dhe përkushtim ndaj vëllezërve. ”

i pacenueshëm, i pashkelshëm. Në këtë drejtim, kjo fjalë që përdorur edhe prej paganëve, për të cilët ishte e shenjtë, d.m.th. e paprekshme e gjithë ajo që i ishte kuashtuar hyjnive. Në krishterim termi “i shenjtë” nuk e humbi domethënien “i paprekshëm”, por atij iu shtua edhe një vlerë tjetër, sepse shenjtërit ishin të “paprekshëm” në saje të shëlbimit që vjen prej Krishtit. Prandaj ekuacioni për të krishterët është ky: *shenjtë baraz me “i paprekshëm”, dhe “i paprekshëm” baraz me i shëlbuar prej Krishtit.*

Prandaj çdo i krishterë i shëlbuar nga Krishti është shenjtë. Në Veprat e apostujve, që do të thotë në kronikat e tri dekadave të para të krishterimit, të gjithë të pagëzuarit quhen shenjtë, sepse janë të shëlbuar nga Krishti. Efekti i shëlbimit të Krishtit është *Hiri* (i tij) që na dërgon në jetën e pasosur, d.m.th. në shpëtimin e *përbërshëm*. Për këtë arsye, me fjalë të tjera mund të thuhet: është shenjtë ai, i cili shpëtohet nëpërmjet meritave të Jezu Krishtit. Janë dhe do të jenë shenjtë edhe të gjithë ata që kanë mëkatuar, por një herë të rikthyer, të penduar dhe të mëshiruar nga dashuria e Zotit.

Dante Alighieri, i cili e njihje shumë mirë doktrinën katolike, vë në Parajsë shumë mëkatarrë dhe disa prej tyre të penduar në momentin e fundit. Prandaj pyetjes: kush janë shenjtërit, duhet përgjigjur: janë ata që shpëtohen, ata që shëlbohen. Atëherë parashtrohet një pyetje tjetër. Atëherë pse kisha ngrit në pedestalin më të lartë vetëm një numër të kufizuar të shenjtërve, pas një procesi shumë të rreptë, prej të cilit duhet të rezultojë patjetër heroizmi i virtyteve të tyre? Për të kuptuar një gjë të tillë, duhet të ndalemi e të mendojmë mbi atë që Kisha propozon dhe promovon, siç është kulti i shenjtërve, me qëllim që të na tregojë shembuj të jetës së krishterë për t'i ndjekur. *Kulti i shenjtërve nuk është triumfalistik, por është pedagogjik.* Kisha, sipas një thënjeje tashmë emblematike të Papës së mirë, Gjonit XXIII, është Nënë dhe Mësuese. Nënë e shenjtërve dhe Mësuese e vir-

tyteve. Kështu që të a. q. shenjtërit e shpallur janë shenjtë shembujnës, shembuj të gjallë që kanë në vetvete tipare pedagogjike, vepra dhe akte që ngjallin tek besimtarët ushtrimin e virtyteve. Prandaj nuk duhet të besohet apo të mendohet që shenjtërit e shpallur janë më të mëdhenj se ata të panjohur apo të pashpallur zyrtarisht nga Kisha. Shenjtërit që kisha i propozon, janë figura shembullore që mund dhe duhet të kenë ndikim pozitiv në jetën e të krishterëve, të cilët, për t'u orientuar në vijën e virtyteve, kanë nevojë për shembuj të mirë dhe ndikim efikas.

### Si t'i njohim shenjtërit?

Në librin e Daljes vërejmë se si Zoti, për t'u drejtuar popullit të zgjedhur, preferon Moisiun e

jo Aronin. E pra, Zoti e zgjedh një njeri “inferior” për të komunikuar një zbulim hyjnor. Mentaliteti ynë e vë këtë problematikë pikërisht në të kundërtën. Për ne shenjtë duhet të jetë një yll (*one stare*) që i kënaq të gjitha idealet tona njerëzore. Por nuk është fare kështu. Shenjtë me stilin e tij i thyen të gjitha ato siguritë tona njerëzore, sepse ka gjetur siguri më të mëdha. Shenjtë ka qëndrime të “çuditshme”, nuk përpiqet dhe nuk mundohet t'i dije të gjitha, por mendja e tij është e drejtuar kah Zoti, kështu që ai e njeh esencien absolute. Shenjtë është një njeri që largohet prej turmave të njerëzve, dhe kur mundet, largohet gjithnjë prej dukjes dhe lavdisë së kotë. Shenjtë na paraqet horizonte të tjera, na ilustron diçka që

nuk është më njerëzore, dhe që është në gjendje të na dhurojë një shpresë stabile. Për shenjtin, Zoti nuk përbën një filozofi, apo një mendim ngushëllues, por është qendra e jetës së tij. Kisha nuk i “bën” shenjtërit, por vetëm i njeh ata, njeh tek ta shenjtat dhe ndikimin e Zotit. Shenjtërit nuk kanë nevojë për ligje të shkruara, sepse e kanë zbuluar njëherë e përgjithmonë që ligji i dashurisë është i shkruar në zemrën e vet. Shenjtë e njeh vërtet Zotin. Për etërit e kishës, miqtë e Hyjit e njohin Atë që e duan, për ndryshe nuk janë miqtë e tij të dashur! Në këtë mënyrë, duke e njohur Hyjin dhe duke pasur intimitet me Të, janë të shndërruar dhe pranojnë prej Tij dhuratën e shenjtërisë.

### Çka kanë bërë shenjtërit?

Të gjithë ata që kanë arritur të nderohen në altarin e shenjtërisë, i kanë jetuar deri në shkallë përsosmërie këshillat ungjillore e i kanë ushtruar në mënyrë heroike të gjitha virtytet, në mënyrë të posaçme fenë, shpresën dhe dashurinë. Secili prej tyre dallohet me ndonjë virtut të veçantë, por të gjithë gati po thuajse i përfshijnë këto tri aspekte fundamentale të jetës asketiko-mistike:

1. Para se gjithash, shenjtërit ishin njerëz të lutjes. Ata të gjithë e kanë kuptuar jashtëzakonisht mirë grishjen e Shën Palit: “jeni të qëndrueshëm në lutje... (Kol 4, 2). Për të qenë të qëndrueshëm, i duhej të mohonin shumë gëzime të kësaj bote, kështu që ata jetuan të zhytur në Hyjin, sikurse peshku zhytet në ujë dhe pa të s'mund të jetojë.

2. Të gjithë shenjtërit e kanë jetuar dhe zbatuar vullnetin e Hyjit, duke marrë mbi vete me durim të gjitha kryqet e jetës. Sikurse Shën Pali, edhe ata kanë dëshiruar të plotësojnë të gjitha ato që mungonin në vuajtjet e Krishtit, në të mirën e Trupit të Tij, që është Kisha (Kol 1, 24).

3. Të gjithë shenjtërit kanë pasur një dashuri dhe kujdes të madh për të varfrit, të sëmurët, jetimët, të braktisurit dhe për të lenët pas dore nga shoqëria, si dhe për mëkatarrë dhe u kanë

ndihmuar atyre në mënyra të ndryshme.

### Nderimi i shenjtërve në kontekstin tonë lokal

Feja e krishterë tek ne shqiptarët tashmë është e ditur që ekziston qysh prej shekujve të parë. Edhe pse gjatë historisë ka pasur shumë vuajtje e sakrificë, megjithatë ajo është ruajtur gjithmonë me “xhelozë”. Ajo ekziston dhe jeton edhe sot e kësaj dite në trojet shqiptare. Në Kishën tonë dhe në jetën fetare të të krishterëve, një vend gjithmonë të pazvëndësueshëm e zë devocioni apo nderimi i shenjtërve. Këtë e tregojnë emrat e pagëzimit që në shumicën e rasteve mbajnë emrat e shenjtërve, festat familjare apo pajtoret e familjeve, shenjtërit-pajtoretë e famullive; prania e truporeve apo shtatoreve që gjenden nëpër kisha dhe nëpër familje të të krishterëve në Kosovë dhe gjetu në trojet shqiptare; pjesëmarrja e madhe nëpër festat e famullive, shtegtimet e ndryshme nëpër shenjtërore, sikur ajo në Letnicë, Gjakovë dhe Laç; besimi i plotë në ndërmjetësinë e shenjtërve. Të gjitha këto elemente tregojnë qartazi se në Kosovë dhe në trojet shqiptare, kulti ndaj shenjtërve është jashtëzakonisht i përhapur.

Por do të thosha: në drejtim të kërkimit të shpresës, të ndihmës dhe të ndërmjetësimi e jo aq në drejtimin pedagogjik; e kjo do të thotë, që, nga shenjtërit të mësohet rruga e jetës. Prandaj do të ishte e udhës që gjithë kësaj dashurie, respekti dhe nderi që ekziston prej shenjtërit e shpallur zyrtarisht nga Kisha, t'i shtohet edhe ky aspekt pedagogjik: të njohim në thellësi jetën e tyre dhe të jetojmë çdo ditë prej shembullit të mirë të tyre, duke e jetuar fenë, shpresën dhe dashurinë në mënyrë heroike. Po e përfundojmë me fjalët e Shën Terezës së Krishtit fëmijë: *‘shenjtërit nuk vdesin kurrë, ata nuk plaken kurrë. Janë dhe do të mbesin gjithmonë dëshmitarë të rinisë së Kishës. Ata nuk bëhen kurrë personazhe të të kaluarës. Përkundrazi, ata janë burra dhe gra të së ardhmes ungjillore, dëshmitarë e botës së ardhshme’.*



“ Termi apo fjala *shenjtë* mund të themi që rrjedh prej fjalës semitike *qades*, gjë e shenjtë, shenjtëri, me kuptimin “*pres, ndaj*” dhe na çon drejt një ideje me ndarjen prej profanës. Origjinën e kësaj fjale mund ta gjejmë edhe prej fjalës latine *sancire*, që do të thotë i padhunueshëm, i paprekshëm, i pacenueshëm, i pashkelshëm. Në krishterim termi “i shenjtë” e ka kuptimin “i paprekshëm në saje të shëlbimit që vjen prej Krishtit. Prandaj ekuacioni për të krishterët është ky: *shenjtë baraz me “i paprekshëm”, dhe “i paprekshëm” baraz me i shëlbuar prej Krishtit.* ”

## Etërit e Kishës

## Shën Ireneu i Lionit (130–200)

■ SHKRUAN:  
Don Marjan DEMAJ

U lind rreth vitit 130 në Smirne apo diku në rrethinën e saj. Si i ri kishte pasur rast të dëgjonte Polikarpin. Ireneu jetonte në një vend të intelektualëve teologjikë. Së këndejmi, edhe Ireneu ishte pajisur me një dije të tillë. Nuk dihet shkaku i shkuarjes së tij në Gali. Në vitin 177 Ireneu e shohim të jetë i deleguari i martirëve të Lionit për çështjen e montanizmit te papa Eleuteri. Po të njëjtin vit vdes ipeshkvi i Lionit Potini. Në vend të tij zgjidhet ipeshkëvi Ireneu.

Vdes si martir në moshën e shtyrë, 70-vjeçare. Martirizohet sikurse të parët e tij, bashkë me dyzetë besimtarë. Nuk dihet saktësisht data e vdekjes. Vdes rreth v. 202, gjatë sundimit të mbretit Septimium Severi, salvus i Kishës.

Vepimtaria e tij kryesore ishte shpallja e Ungjillit në Gali dhe në mënyrë të veçantë ai luftoi kundër agnosticizmit.

Shën Ireneu, si teolog dhe bari të zellshëm, e hasim në disa vende si ndërmjetësues pajtimi mes rrymave të ndryshme në Kishë në kohën e tij, në veçanti rreth çështjes së montanizmit kur ai i sugjeron papës Viktorit

të mos e dënojë me ngut, por le ta ketë në dispozicion një kohë shqyrtimi. Po ashtu Ireneu e hasim të pranishëm në të a. q. "nyjën pashkëvore" mes Kishës në Azi të Vogël dhe Romës. Ireneu këtu ndërmjetësoi që mos të shkaktohet ndarja eventuale mes të kishave, por të arrihet pajtimi për sa i përket datës se kur duhet të kremtohet dita e Pashkës.

## Veprat teologjike

Sipas Euzebit, Ireneu shkroi shumë vepra në gjuhën e tij amtare greke. Nga to, janë të ruajtura vetëm dy: *Adversus haereses* (Kundër herezive - gnozës) dhe *Demonstratio praedicationis apostolicae - gr. Epideixis tou apostoliku kerygmatos* (Paraqitja e predikimit apostolik).

Vepra e parë ka pesë libra. Është e shkruar rreth viteve 178–188. Kjo vepër flet kundër gnostikëve dhe herezive në tërësi. Për sa i përket stilit të shkrimit, ka një bazë të fortë teologjike. Si shembull e merr gnozën e Valentinit. Në librin e tretë përdor Shkrimin e Shenjtë, sidomos librat e Besëlidhjes së Vjetër.

Libri i katërt flet kundër gnostikëve për *Domini sermones* (Fjalimet e Zotit), duke cekur bashkësinë e dy Besëlidhjeve, e cila paraqet argumentin theme-

lor në këtë polemikë.

Libri i pestë flet mbi të ngjallurit e korpit (trupit), të cilën gjë e mohojnë gnostikët, dhe në fund flet mbi eskatologjinë.

Vepra e Ireneut është një burim i çmuar për historinë e Kishës, po edhe për letërsinë, sepse ai, për t'i kundërshtuar herezitetë, ka përdorur veprat origjinale të atyre shkrimtarëve të cilët i kundërshton. Po ashtu, ai paraqet themelet e para teologjike sistematike kishtare.

Vepra e dytë *Demonstratio praedicationis apostolicae*, e cila është gjetur më 1904 në përkthimin armen, është vepër e të gjitha të vërtetave të fesë dhe mjaft e thjeshtë. Një si tendencë e parë, del pikësynimi për të krijuar një katekizëm biblik. Libri ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë flet mbi simbolin e fesë (Besojma) dhe të vërtetat e fesë (Zoti, krijimi, njeriu, rënia e tij në mëkat, historia e shëlbimit, mishërimi i Jezu Krishtit dhe shëlbimi). Pjesa e dytë është kristologjike, ku e përpunon plotësimin e profetizimit mesianik të Jezu Krishtit.

M. Dufourcq e ka vlerësuar Ireneun kështu: "Ai e ka rënur agnosticizmin dhe ka themeluar teologjinë katolike." Harnacku thotë se Ireneu i ka dhënë teologjisë përmbajtjen.

Fragment nga "Traktati kundër herezive"  
(Lib. 4, 20, 5-7; SC 100, 640-642, 644-648)

## Njeriu i gjallë është lavdia e Hyjit; Jeta e njeriut është shikimi i Hyjit


Lavdia e Hyjit jep jetën; për këtë arsye ata që e shohin Hyjin e fitojnë jetën. Dhe pikërisht për këtë arsye ai që është i paarritshëm, i pakuptueshëm dhe i padukshëm, bëhet i dukshëm, i kuptueshëm dhe i arritshëm nga njerëzit, për t'u dhënë jetën atyre që e kuptojnë dhe e shohin. Është e pamundur të jetohej nëse nuk e kemi pranuar jetën, por jetën nuk mund ta kemi ndryshe, veçse me pjesëmarrje në qenien hyjnore. Kjo pjesëmarrje qëndron në pamjen e Hyjit dhe në të shijuarit e mirësisë së tij.

Njerëzit, pra, do ta shohin Hyjin për të jetuar, dhe do të bëhen të pavdekshëm dhe hyjnorë në sajë të shikimit të Hyjit. Kjo gjë, siç thashë edhe më parë, ishte zbuluar në profetët në trajtën e një shëmbëlltyre, që do të thotë se Hyji ishte parë nga njerëzit që e bartin Shpirtin e tij dhe e presin gjithmonë ardhjen e tij. Kështu Moisiu në Ligjin e përtërirë pohon: Sot e kemi parë se Hyji mund të flasë me njeriun dhe njeriu të mos vdesë (khs. Lp 5, 24).

Ai që bën gjithçka me tërë madhërinë dhe pushtetin e tij, që është i papashëm dhe i papërkrahshëm për të gjitha qeniet që ai vetë i ka krijuar, nuk mbetet i panjohur; vërtet të gjithë, nëpërmjet Fjalës së tij, mësojnë se Ati është Hyji i vetëm, që i përmban të gjitha gjërat dhe u jep të gjithave qenien, siç është shkruar në Ungjill: "Hyji kurrë askush nuk e pa: Biri i vetëm – që është Hyj, një natyrë me Atin, Ai bëri të njihet" (Gjn 1, 18).

Që nga fillimi, pra, Biri është ai që e zbulon Atin, sepse ai është me Atin që nga fillimi dhe Ati me të, dhe i ka shfaqur gjinisë njerëzore në kohën e volitshme vegimet profetike, dallueshmërinë e dhuntive, misteret dhe lavdërimin e Atit sipas një paraktimit krejtësisht të rregullt dhe krejtësisht në harmoni. Dhe ku ka rregull ka dhe harmoni, dhe ku ka harmoni ka edhe kohë të volitshme, e ku ka kohë të volitshme ka edhe dobi.

Për këtë arsye, Fjala është bërë mbarështues i hirit të Atit për njësimin e njerëzve, për dobinë e të cilëve e ka rregulluar gjithë "ekonominë" e shëlbimit, duke u treguar Hyjin njerëzve, dhe duke ia paraqitur Hyjit njeriun. Por e ka ruajtur padukshmërinë e Atit, që njeriu mos ta përçmojë Hyjin dhe të ketë gjithmonë diçka drejt së cilës të tendoset. Në të njëjtën kohë e bëri Hyjin të dukshëm për njerëzit me shumë ndërhyrje të provanisë së tij, që njeriu mos të lihej krejtësisht pa Hyjin, dhe të binte kështu në asgjësinë e tij, sepse njeriu i gjallë është lavdia e Hyjit dhe jeta e njeriut është shikimi i Zotit. Nëse pra zbulimi i Hyjit nëpërmjet krijesës i dhuron jetën të gjitha krijesave që gjenden mbi tokë, shumë më tepër zbulimi i Atit që bëhet përmes Fjalës, është shkak i jetës për ata që e shohin Hyjin.



Shën Ireneu



Harta e Galisë



# Sa e njohim vërtet në familje njëri-tjetrin?

*Në jetën familjare dhe në zhvillimin e anëtarëve të saj, komunikimi i bazuar në njohjen e njëri-tjetrit është themeli, pa të cilin ajo shembet dhe tretet. Eksperienca e jetës tregon se një komunikim i mirë është i domosdoshëm për një marrëdhënie funksionale. Nëse jemi në gjendje të flasim në mënyrë konstruktive, atëherë mund të zbulojmë te njëri-tjetri gjithnjë gjëra të reja, t'i tejkalojmë së bashku krizat dhe kështu ta formojmë një jetë të përbashkët më të lumtur dhe më të kënaqshme. Mirëpo, shpeshherë pikërisht komunikimin me partnerin/partneren apo me anëtarët e familjes e lëmë pas dore.*

■ SHKRUAN:  
P. Shtjefën DODES SJ

Në takim me shumë çifte bashkëshortore shpesh herë këshilltarët familjarë mbesin me gojë hapur duke e pyetur veten: a thua me të vërtetë është e mundshme që pas dhjetë e më shumë vjetëve të një jete të përbashkët, këta njerëz aq pak po u njohkan ndërmjet veti, aq pak po ditkan njëri për tjetrin? Vetëm para se të ndahen ia zbulojnë njëri-tjetrit atë që me vite e kanë mbajtur brenda. Është dashur që të urrehen ndërmjet veti në mënyrë që ta shprehin atë çka mendojnë përnjëmend njëri për tjetrin. Shumë nga ajo çka thonë para ndarjes së martesës, ndodh të jetë me plot të panjohura të njëri-tjetrit ose të njohjes së gabuar të njëri-tjetrit. Shumica prej çifteve me ofshamë konstatojnë: "Po ta kisha ditur këtë më herët, ndoshta nuk do t'ish-te shkaktuar e gjithë kjo!" Po përse nuk ma ke thënë këtë më parë?"

Njohja e shoqi-shoqit të çiftit martesor është kusht i domosdoshëm jo vetëm i dashurisë së suksesshme martesore, por edhe i aftësisë për të qëndruar i pamposhtur nga vrullet e të përditshmes bashkëshortore shpeshherë të pakëndshme dhe të mundimshme. Çiftet që njihen mirë njëri me tjetrin janë të gatshëm t'iu bëjnë ballë ndodhive shumë të vështira dhe konflikteve. Sa më shumë të njihen dhe të kuptohen në mes veti, aq më lehtë e mbajnë kontaktin, lidhjen e ndërsjellë, kur kjo lidhje lëkundet.

Ndoshta edhe Ju, i dashur lexues, e dashur lexuese, e keni atë ndjenjë se çifti yt apo anëtar i familjes nuk po të dëgjon si duhet. A jeni të sigurt se edhe Ju vetë jeni duke e dëgjuar me vëmendje partnerin tuaj apo anëtarin për të cilin po ankoheni?

## Çka domethënë të dëgjosh?

Me vetë faktin se qëndrojmë përballë një tjetri, se çka ai/ajo është duke thënë; se ne zërin ia dëgjojmë; nuk do të thotë automatikisht që ne jemi duke dëgjuar si duhet. Të dëgjosh, para së gjithash, domethënë se ne jemi duke provuar të kuptojmë

atë çfarë është duke na thënë personi përballë.

Shpesh herë ndodh që zëri i tjetrit mund të jetë aq familjarizues, aq shumë jemi mësuar me të, sa që atë çfarë ai/ajo thotë zakonisht e marrim si të vetëkuptueshme dhe mendojmë se nuk është diçka e re. Prandaj mund të ndodhë që thjesht në vend që të dëgjojmë, të jemi me mendime krejt diku tjetër.

Kështu shkruan psikoterapisti Brajsha: "Më kujtohen eksperimentet me çiftet martesore për këtë temë. Të dytë i kam kontrolluar/pyetur për të dhënat me banale për partnerin e tyre bashkëshortor. Rezultatet kanë qenë demoralizuese. Shumica nuk i kanë ditur të dhënat elementare personale të bashkëshortit/es, problemet e tij apo të saj në punë, hobi, dëshirat, nevojat, shpresat, arsyet e pakënaqësisë, ndjenjat e vërteta dhe përjetimet lidhur me jetën e tyre intime. E kam ndërjerë veten sikur po i pyes disa kalimtarë të rastësishëm, disa të panjohur të ndërsjellë, të huaj dhe jo çifte martesore që jetojnë ashtu me vite të tëra."

Nuk duhet harruar, që, nëse ne nuk dëgjojmë si duhet, atëherë as nuk mund të kapim/të kuptojmë si duhet, se si është duke e ndërjerë ai/ajo veten, mirë apo keq, dhe çka është duke kërkuar ai/ajo prej nesh. Për këtë arsye shpeshherë fare nuk e vërejmë, a është ai tjetri i/e mërziur apo i/e gëzuar, me çka është duke u marrë dhe a është duke dashur vërtet të na thotë diçka të rëndësishme. Nëse e shikojmë fillimin e martesës është interesante se kjo atëherë nuk ka ndodhë kështu. Shumica e vërtetojnë se këto doherësh i kanë ditur, por i kanë harruar. Nuk është pra fjala për mosnjohjen primare të shoqi-shoqshme, por për atë sekundare. Është fjala, thotë Brajsha, për një proces të tëhuajësimit të ndërsjellë, të një interesi gjithnjë e më të vogël për njëri-tjetrin, të venitjes së dashurimit dhe dashurisë së parë, të një shndërrimi të bashkësisë martesore në një "bujtinë bashkëshortore", "një fast-food-restorant

bashkëshortor", "të një stacioni autobusash bashkëshortorë", në të cilat vende shkurt takohen të panjohurit dhe kalimtarët e rastësishëm, prej të cilëve as që mund të pritet që njëri për tjetrin të dinë diçka më shumë.

## Disa këshilla për komunikimin në familje

Të dëgjosh domethënë edhe ta kesh vëmendjen. Shumë prej nesh gjatë kohës kur tjetri flet, tashmë mendojmë për kundërgjykimet apo kundërshtimet tonë. Në këtë mënyrë me mendime nuk jemi të bashkëbiseduesi, por shumë më shumë të vetvetja. Shtrohet pyetja, si atëherë mund të dëgjosh në mënyrë të drejtë. Të dëgjuarit e njëmendtë kërkon pak disiplinë, kërkon që të mësohemi, në mënyrë që të jemi

Detyra e dëgjuesit është që në këtë ushtrim të vendoset në shpirtin e tjetrit.

Ekzistojnë njerëz, të cilët, pasi fillojnë të flasim, duket se nuk e kanë njet të ndalen. Ka edhe bashkëbisedues, të cilët më mirë fshihen pas fjalëve të të tjerëve. Për të dyja rastet vlen rregulli: jo monolog, sepse monologu nuk është bisedim.

Kur bisedojmë me tjetrin, ishte dashur ta kemi gjithmonë parasysh, se na duhet edhe koha e atij që është përballë nesh. Ne, për fat të keq, harrojmë shpesh herë, që në një bisedë nuk e harxhojmë vetëm kohën tonë, por edhe të tjetrit. Për këtë arsye është e rëndësishme, herë pas here t'ia sqarojmë vetvetes, se personi përballë nesh po na dhuron kohën e vet. Ta përdorim me

në drejtim të kundërt apo ndryshimi total vetëm p.sh. që një njeri më pak kuvendar tani të bëhet gojtar i fortë. Shumë më e rëndësishme është të dallohet se në komunikim gjithmonë marrin pjesë dy njerëz. Një njeri vetë nuk mund ta mbajë një komunikim funksional. Për këtë arsye duhet të kontribuojnë të dyja anët. Vetëm kështu komunikimi mund të jetë efektiv, i qëndrueshëm.

Ta marrësh përgjegjësinë në marrëdhënie do të thotë ta ndësh veten të përgjegjshëm për një komunikim efektiv. Këtu, prej pjesës më mirë të heshtur kërkohet që diçka më shumë të thotë, kurse prej pjesës më mirë kuvendare, tjetrit t'ia japë më shumë hapësirë për të folur.

Natyrisht se të gjithë ne kemi

**“Çiftet që njihen mirë njëri me tjetrin janë të gatshëm t'iu bëjnë ballë ndodhive shumë të vështira dhe konflikteve. Sa më shumë të njihen dhe të kuptohen në mes veti, aq më lehtë e mbajnë kontaktin, lidhjen e ndërsjellë, kur kjo lidhje lëkundet.”**



dëgjuës aktivë dhe konstruktivë.

Mund të provojmë qysh sot një ushtrim të vogël, duke provuar që ulur apo në këmbë para tjetrit ta përsërisim saktë atë çka pikërisht e dëgjuat prej tjetrit. Sa më e komplikuar dhe gjithpërfshirëse të jetë e thëna, aq më vështirë do të jetë ripërsëritja. Në këtë ushtrim provojmë njëri-tjetrit t'ia përsërisim fjalët, mirëpo duke e pasur parasysh se këtu nuk kemi të bëjmë me të pasurit të drejtë apo jo. Ndiham shumë nëse në fillim gjendet një person neutral, në mënyrë që, si person i tretë, të na provojë objektivisht përsëritjen tonë. Kryesorja është që ta provoni njëri-tjetrin sa mirë dëgjoji dhe sa mirë e kuptoni njëri-tjetrin. Këtë ushtrim mund ta bëni dyanshmërisht.

kujdes këtë kohë dhe jo vetëm ta shfrytëzojmë dhuratën. Nuk është e çuditshme, kur tjetri nuk ka më vullnet, të mos bisedojë me ne, kur vetëm ne dëshirojmë të flasim dhe tjetrit nuk i jepet rasti.

Ekzistojnë njerëz me karaktere të ndryshme biseduese. Disa bisedojnë me gjallëri dhe janë shumë kuvendarë, disa të tjerë janë më shumë të qetë dhe të tërhequr. Vetë të tilla të ndryshme çojnë shpesh në mosbaraspeshë në pjesëmarrjen në bisedë, me të cilën të dy dëshirojnë të jenë të kënaqur. Këtu duhet të kihet para sysh që një mosbaraspeshë e tillë të mos manifestohet vazhdimisht dhe të mos grumbullohen me kohë shumë gjëra tek personi që është më shumë i heshtur.

Qëllimi nuk është përthyerja


aso fazash në jetë, në të cilat kemi nevojë të madhe veçanërisht për të biseduar, p.sh. kur nuk e ndiejmë veten mirë apo kur punojmë për të zgjidhur një problem. Atëherë është në rregull më shumë të flasësh se tjetri. Mirëpo nuk do të duhej këtë ta shpërdorojmë në mes dy njerëzve. Prandaj duhet pasur parasysh baraspeshën në mes të dy pjesëmarrësve në bisedë.

Për ta ruajtur jetën cilësore në familje dhe martesë, për ta mbajtur dhe për ta rigjallëruar gjithmonë sërishmi dashurinë bashkëshortore, përveç "miqësisë martesore" është e nevojshme edhe njohja e shoqësive dhe çiftit martesor ose, thënë më shkurt, "njohja bashkëshortore" – njohja e njëri-tjetrit.



Papa Pali VI

Stema e Palit VI



# Papa i ekur

*Me rastin e 30-vjetorit të kalimit në paraqesim në pika të shkurtra para le reformatave konciliare, ekumenizmit, çështje kyçe: moralin njerëzor duke vëmendos ndaj të varfërve. Ndërhyrjet e tij nevojë dhe detyrë e Kishës edhe në di-*

## ■ SHKRUAN: Don Agim QERKINI

### Jeta

Giovanni Battista Montini – Papa Pali VI, u lind më 26 shtator 1897 në Concesio, në rajonin e Brescia-s. Prindërit e tij Giorgio Montini dhe Giuditta Alghisi kishin edhe dy fëmijë tjerë: Ludovikun dhe Francesco-n. Pas shkollimit të rregullt 19-vjeçar, ai hyn në seminar dhe në vitin 1920 shugurohet meshtar. Pastaj do të vazhdoj studimet teologjike dhe të drejtësisë në Universitetin Papnor të Gregorianës në Romë.

Në vitin 1923 papa Piu XI e dërgon me detyrë në nunciaturën e Varshavës, mirëpo për shkak të arsyeve shëndetësore largohet nga kjo detyrë. Pas kësaj, do të punoj në Sekretarinë e Shtetit, në kohën e kardinalit Gaspari, ndërsa prej vitit 1931 ligjëron në Akademi historinë e diplomacisë. Më vonë do të punojë edhe si bashkëpunëtor i ngushtë i sekretarit të Shtetit, kardinalit Eugenio Pacelli, i cili më 1939 do të zgjidhet papë me emrin Piu XII. Ky bashkëpunim me Papën do të vazhdoj edhe më vonë, deri kur, më 1954 Piu XII e emëron për arqipeshkëv të Milanos. Katër vite më vonë Papa Gjoni XXIII e emëron kardinal.

Në tetor 1962 do të filloj punimet Koncili II i Vatikanit. Më këtë rast, Papa dëshiron të zbattoj, siç thoshte ai, *aggiornamento*, d.m.th., *përditësim* në Kishë. Mirëpo, këtu duhet përmendur faktin se, Papa Gjoni XXIII nuk kishte një program konkret të zhvillimeve të punimeve të Koncilit, kështu që, Kardinali Montini do të krijoj një rend të shkëlqyer i cili bëri që Koncili të ecën mbarë. Ai në 11 faqe të shkruara me dorë do të propozoj vijën e qartë të këtij programi, si nga përmbajtja ashtu edhe për nga organizimi, duke marrë edhe mbështetjen e shumicës së ipeshkvijve me çka i sigurohet e ardhmja Koncilit. Papa Gjoni XXIII vdesë tetë muaj më vonë, kështu që ndërpriten punimet e Koncilit dhe procedohet me zgjedhjen e Papës së ri. Në konkllava do të marrin pjesë 80 kardinal dhe në raundin e pestë të zgjedhjeve më 21 qershor 1963, Giovanni Battista Montini zgjedhet pasardhësi i shën Pjetrit, i 262 me radhë, duke marrë emrin Pal, sipas shembullit të Palit apostull.

### Pontifikati

Papa Pali VI, që në fillim të pontifikatit vendosë që shërbesën e tij papnore ta orientojë në katër drejtime: a) *vazhdimin e Koncilit*; b) *bisedimet për bashkim me*

*Kishën e Lindjes*; c) *paraqitja më e hapur ndaj kishave të krishtera Perëndimore dhe d) hapja e Kishës ndaj botës moderne*. Kështu, Papa pothuajse në të gjitha fjalimet e veta apo edhe në udhëtimet që do t'i ndërmerr, do të ketë për bazë të paktën një prej këtyre pikëqellimeve.

Është me rëndësi të theksohet se Papa Pali VI, në veçanti do të vihet në mbrojtjen e të varfërve. Papa Pali VI është Papa i parë, i cili në vizitat e tij pastorale përdori aeroplanin dhe i pari që do t'i vizitot pesë kontinentet. Udhëtimi tij i parë do të jetë gjashtë muaj pas zgjedhjes Papë edhe atë pikërisht në Tokën e Shenjtë. Në dhjetor të vitit 1964 ai do të vizitot Indinë, me ç'rast i akuzon popujt e pasur e të industrializuar për shkak të mos solidarizimit me të varfërit. Ndërsa, një vit më vonë Papa viziton edhe SHBA-të, dhe me këtë rast në Kombet e Bashkuara në Neë York mbanë fjalimin që ia kushton paqes dhe stabilitetit botëror.

Pas përfundimit të Koncilit, themelohen Komisionet e ndryshme papnore, të cilat do të ndihmojnë në aplikimin e normave të reja dhe përfundimeve që kishite sjellë Koncili. Për besimtarët më e rëndësishmja ishte ndryshimi i riteve. Mesha tani duhej kremtuar me fytyrë kah populli, dhe

përpos kësaj, edhe ndryshimet tjera që ishin ndërmarrë, ishin pranuar mirë dhe e gjithë kjo do t'i jep një frymë të re Kishës së përgjithshme.

Akti tjetër historik do të jetë takimi i Papës Palit VI me Patrikun ortodoks Atenagorën, me prejardhje shqiptare, më 1964 kur do ta ndërpresin ekskomunikimin e ndërsjellë në mes Romës dhe Konstantinopolit, me të cilin në vitin 1054 ishin larguar Lindja dhe Perëndimi, duke shkaktuar ndarjen e thellë mes veti.

Papa Pali VI do të quhet "Papa i paqes" dhe "Papa shtegtar", pikërisht për shkak të udhëtimeve që do të ndërmerr edhe në të ardhmen.

### Enciklikat e Papës Palit VI

Enciklika (nga greqishtja *enkyklios*, "në rreth") është një letër pastorale e Papës për Kishën Katolike mbi argumentet doktrinale, morale apo sociale, drejtuar ipeshkvijëve të Kishës Katolike, e përmes tyre gjithë besimtarëve.

Përveç 20 Kushtetutave dhe shumë Letrave tjera apostolike, të shpallura nga Shenjtëria e tij Papa Pali VI, po përmendim këtu 7 Letrat enciklike të tij: *Ecclesiam Suam* (6 gusht 1964); *Mense Maio* (29 prill 1965); *Mysterium Fidei* (3 shtator 1965); *Christi Matri* (15 shtator 1966); *Populorum Progressio* (26 mars

1967); *Sacerdotalis Caelibatus* (24 qershor 1967); *Humanae Vitae* (25 korrik 1968).

Secila prej këtyre Enciklikave padyshim ka rëndësinë e vet për mbarë Kishën, por në disa prej tyre, Papa do të trajtoj edhe interesin mbarë njerëzor. Në rend të parë duke mbrojtur të drejtat e punëtorëve (*Populo-*



Dy papër, Gjoni XXIII e Pali VI, udhëheqës të Koncili

Me rastin e 30 vjetorit të vdekjes së Papës Palit VI (1978-2008)

# Papa Pali VI

## nenizmit, dialogut dhe paqes

*Amshim të Papës Palit VI, njeriu i cili i dha aq shumë Kishës dhe mbarë njerëzimit, po e exuesve figurën e tij, me qëllim që të rikthejmë kujtimin për të dhe punën e tij të vrullshme rreth dialogut dhe paqes. Mësimi i tij në Letrat e shumta dhe veçmas në Enciklika, ndër tjera prekë dy e çuar të drejtat e njeriut, dhe anën sociale të tyre, të cilën do ta shpreh me një kujdes të madh sidonj në këto fusha, të cilat do të bëjnë kthesë të madhe për mbarë shoqërinë, vazhdojnë të jenë aktuale, tët e sotme.*

rum Progressio). Në këtë enciklikë Papa shpalos vizionin e vet për një botë më të drejtë duke ngritur zërin për botën e Tretë dhe duke ftuar të pasurit në solidaritet.

Pastaj, enciklika *Humanae Vitae* në të cilën Papa përqendrohet në vlerat njerëzore, duke theksuar se dashuria në

martësë duhet të gëzojë deri sa të jetë e mundur lindja e fëmijëve. Në këtë enciklikë Papa i ndalon mjetet kontrceptive. Kjo Letër e tij deri sa në Amerikën latine pranohet mirë, ajo do të jetë në qendër të kritikave të botës moderne, sidomos në Gjermani.


Në enciklikën *Sacerdotalis*

*coelibatus* Papa do të insistoj në domosdoshmërinë e celibatit të meshtarëve. Në vitet pas Koncilit ai i laicizon mbi 30 mijë meshtarë, dhe siç kishte pohuar edhe vet: ky kishte qenë kryqi më i madh i tij.

Papa Pali VI do të vazhdojë të sjell risi në Kishë edhe duke u caktuar ipeshkvijve kohën e pensionimit kur të mbushin 75 vjet, që një kardinal me të mbushur 80 vjet nuk mund të zgjedhet papë, pastaj do të zgjerohet dhe ndërkombëtarizoj Kolegjin e kardinajve, sikundër dhe cakton që në konklava nuk duhet të ketë më shumë se 120 kardinaj.

Herën e fundit kur Papa Pali VI del para publikut është 9 maji i vitit 1978, në Meshën përkujtimore për politikanin Aldo Mora i cili ishte një mik i tij.

Më 6 gusht 1978 Papa Pali VI vdes papritmas nga pasojat e një sulmi kardiak në pushimoren e tij në Castel Gandolfo. Para se të vdiste kishte caktuar Shën Palin: "Tash mund të shkoj i qetë. Luftën e mirë e luftova, vrapimin e kreuva, fenë e ruajta". Trupi i tij është bartur në Vatikan. Përkundër të gjithave, pontifikati i Papës Palit VI është një prej më të rëndësishmëve të shekullit XX, Papë të cilin e karakterizoi reforma dhe dialogu.



it II të Vatikanit



Pali VI si kardinal, bashkëpunëtor i ngushtë i Papës Pio XII

Intervistë me Arbër Xhaferrin

# Shqiptarët janë ndër të parët evropianë që e pranuan krishterimin nga v

*Dy dekadat e fundit për shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë shënjojnë një kthesë të madhe drejt asaj që ne e quajmë pranimi i të genit në shtratin tënd të lindjes. Ka pasur pak raste në historinë tonë ndërrime të këtitilla që kanë qenë në drejtim të dubur kombëtar, me qëllim për të pasur atë që na është marrë nga duart që disa shekuj. Për këtë ndërrim kanë kontribuar njerëz tanë të përkushtuar, pa i përjashtuar miqtë tanë perëndimorë, duke u flijuar në sfera të ndryshme, me qëllim të përmirësimit të çështjes kombëtare. Po ashtu këto njëzet vjetet e fundit do të shënohen si një epokë e diskutimeve të shumë çështjeve të nxehta, siç thubet, për sa i përket identitetit tonë shqiptar, se a jemi evropianë apo lindorë? Zotëri Arbër Xhaferrin, njihet në skenën politike dhe kulturore që ka kontribuar konsiderueshëm në/ për çështjen shqiptare në përgjithësi. Me që ai ditët e fundit është tërhequr nga angazhimi aktiv politik, e konsideruam shumë të qëllim të për të bërë një intervistë me të, për disa çështje të identitetit tonë evropian e të politikës sonë, si dhe për çështjen shqiptare në përgjithësi.*

## Kush janë shqiptarët në Maqedoni, sa janë? Ku janë shqiptarët e krishterë atje, a ka të tillë, apo çfarë ishte fati i tyre?

**A. Xhaferrin:** Shqiptarët, kudo qofshin ata, janë shqiptarë pa marrë parasysh juridiksonin administrativ, besimin, bindjet ideologjike, dialektin, larushinë folklorike etj. Deri më tani kemi funksionuar, në momentet më të vështira historike, si një komb, sidomos gjatë krizës kosovare, kur u arrit një homojenitet, një kohezion impresiv, pa marrë parasysh dallimet.

Jemi një komb, ngaqë pajtohemi rreth çështjeve më të rëndësishme që formojnë identitetin kombëtar:

- jemi popull autokton, me origjinë evropiane, pasardhës të ilirëve;
- jemi ndër evropianët e parë që nga vetë apostujt e pranuan krishterimin;
- flasin një gjuhë, tashmë edhe të standardizuar, që është njëra nga 6 gjuhët fundamentale evropiane;
- pranojmë se kemi histori të përbashkët, pa dallime sinjifikante në interpretim;
- pranojmë se kemi një kulturë;
- i ndërojmë pa dallime personalitetet historike, kulturore kombëtare;
- kemi gjetur dhe pranuar formulën për tolerancën fetare, atë të Pashko Vases, që është shndërruar në maksimum obligues për të gjithë shqiptarët; "Feja e shqiptarit është shqiptaria";
- dëshirojmë të jetojmë, të veprojmë dhe ta ndërtojmë bashkë ardhmërinë tonë, etj.

Këto janë bindjet të pamohueshme të çdo shqiptari. Deri më tani nuk kemi opsione të kundërta që do t'i kontestonin këto përcaktime. Natyrisht që ka dallime të ndryshme që krijojnë identitete dytësore apo tretësore, ashtu si në radhët e çdo populli tjetër.

Pra, shqiptarët e Maqedonisë janë një pjesë përbërëse e kombit që kanë të njëjtin identitetet (histori, gjuhë, traditë, kulturë) dhe gatishmëri që të frymojnë njësoj si pjesëtarët e tjerë të kombit shqiptar. Nga gjiri i popullit shqiptar të Maqedonisë dolën dy nobelistë: Nëna Terezë dhe Ferid Muradi. Sipas të dhënave të ndryshme, bie fjala, numrit të filo-

ristëve në Maqedoni më së paku 1/3 e popullsisë janë shqiptarë, të cilët vazhdojnë ta ndërtojnë identitetin kombëtar mbi principet e njëjta si në hapësirat e tjera shqiptare. Këtë proces të kombformimit do ta përshpejtojnë dy universitetet që funksionojnë në Tetovë.

Në Maqedoni kanë lënë gjurmë të pashlyeshme shqiptarët e krishterë të rritit katolik, duke filluar nga Pjetër Bogdani deri te Nëna Terezë, pastaj ata të rritit ortodoks që banojnë në rajonin e ashtuquajtur të Rekës, rreth Gostivarit. Ata flasin një gjuhë të pastër, madje sipas disa gjuhëtarëve më të kulluar se gëgërishtja e vëllezërve të tyre myslimanë që është një fenomen atipik,

**“** Në Maqedoni kanë lënë gjurmë të pashlyeshme shqiptarët e krishterë të rritit katolik, duke filluar nga Pjetër Bogdani deri te Nëna Terezë, pastaj ata të rritit ortodoks që banojnë në rajonin e ashtuquajtur të Rekës, rreth Gostivarit. Ata flasin një gjuhë të pastër, madje sipas disa gjuhëtarëve më të kulluar se gëgërishtja e vëllezërve të tyre myslimanë që është një fenomen atipik, i rrallë. Josif Bageri, pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit, ka qenë shqiptar ortodoks i këtyre anëve. Në Manastir dhe rrethinë eksitojnë gjurmët e shqiptarëve protestantë, kryesisht pasardhësit e familjes Qiriaz. Mjerisht, për shakaq të ndryshme, identitetin kombëtar e kanë ruajtur vetëm të krishterët katolikë. Ata kryesisht jetojnë në Shkup. **”**

i rrallë. Josif Bageri, pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit, ka qenë shqiptar ortodoks i këtyre anëve. Në Manastir dhe rrethinë ekzistojnë gjurmët e shqiptarëve protestantë, kryesisht pasardhësit e familjes Qiriaz. Mjerisht, për shakaq të ndryshme, identitetin kombëtar e kanë ruajtur vetëm të krishterët katolikë. Ata kryesisht jetojnë në Shkup.

**Këtu, në Ballkan, lindi një shtet i ri, Kosova. Ka shumë të tillë që provojnë ta krijojnë edhe një komb të ri, të quajtur 'kosovar' dhe ndoshta edhe një gjuhë të re 'kosovare'. A është kjo një pasurim, begatim apo një 'sakatim' i qenies sonë si shqiptarë?**

**A. Xhaferrin:** Edhe me këtë rast do të verifikohet se jemi popull evropian. Evropianët kanë veti që të krijojnë një strumbullar të përbashkët. Në Evropë ndjenjat kombëtare kanë luajtur një rol antagonist, ndërtes dhe rrënuës. Ndjenja kombëtare ndikoi që të bashkohen feudet dhe të krijohen shtetet moderne nacionale, siç ishte rasti me Gjermaninë dhe Italinë, po ashtu ndjenjat kombëtare ndikuan që të shformohen perandoritë mbinacionale siç ishte ajo austro-hungareze. Nacionalizmi është rrethim evropian. Latinët kanë një maksimum që u vërtetua katërcëprish në Evropë: "Quis lingua eius regio" ("E kujt gjuha - e tij toka"). Prandaj mendësia evropiane prodhonte kon-

normativizohet, të standardizohet. Bie fjala, në bibliotekat moderne respektohen standardet e mikroklimës që e ruajnë librin nga dëmtimet. Kështu është edhe me gjuhën. Nëse duam ta ruajmë gjuhën, atë ind të vetëm të përbashkësisë, të unitetit tonë, duhet ta kultivojmë dhe ta respektojmë gjuhën standarde shqipe, ashtu si ruhet anglishtja që përdoret njësoj prej SHBA-ve deri në Australi, prej Afrikës së Jugut deri në Britaninë e Madhe. Kjo vlen edhe për gjuhët e tjera evropiane, pos për gjuhët sllave që shumohen artificialisht, gjithnjë në funksion të ekspansionizmit.

Zërat për krijim të kombit të ri dhe gjuhës së re në Kosovë janë jo serioze, ngaqë vijnë nga margjinat e shoqërisë. Deri më tani elita politike dhe shkencore e Kosovës e ka ruajtur atë frymë kombëtare të përuar në periudhën e Rilindjes kombëtare.

Për mua, këto ide për komb dhe gjuhë të re janë absurde dhe në funksion të shkërcimit të kapaciteteve kombëtare të shqiptarëve.

**U bënë 130 vjet nga Lidhja e Prizrenit, a i kanë arritur shqiptarët synimet e veta si popull, apo duhet të presim edhe 130 vjet të tjera?**

**A. Xhaferrin:** Disa thonë se shqiptarët vonë paskan krijuar vetëdijen kombëtare. Edhe pse për këtë tezë mund të gjenden argumente të shumta, megjithatë mendoj se rasti shqiptar është një raritet historik. Të gjithë popujt e lashtë, shqiptarët janë popull i lashtë, janë zhdukur, ose janë asimiluar. Po ashtu të gjitha gjuhët e lashta janë të vdekur, pos shqipes. Së këndejmi, shqiptarët, si popull atipik, pa sponsor të fuqishëm, arritën çuditërisht të mbijetojnë në rajonin më frekuent të botës, ku dyndeshin fise aziatike, ku përplaseshin interesa, kultura, qytetërimi nga më të ndryshmet. Mbijetesa e shqiptarëve është një mrekulli hyjnore. Ky proces i mbijetesës dhe i kombformimit vazhdon. Lidhja e Prizrenit, Konferenca e Londrës, Konferenca e Rambujesë apo kjo e fundit e Vjenës, janë shkakë që kujdeshëm na shpijnë drejt përfundimit të procesit të shtetformimit dhe kombformimit të shqiptarëve. Ky proces zhvillohet në Evropë dhe këtë fakt s'duhet të harrojmë asnjëherë. Vetëm me interiorizim të vlerave dhe të standardeve evropiane mund ta përfundojmë suksesshëm këtë proces.

**Të gjithë ata që flasin shqip, a janë një komb? A e kemi të njëjtin identitet të gjithë, kur i kemi parasysh divergjenat dhe dallimet brenda përbërësve, në kulturë, në gjuhë, në të shprehur, në të menduar, në religjion?**

kanë shkruar në gjuhën shqipe të nxitur nga arsyet fetare, por edhe nga ato edukative dhe letraro-gjuhësore”. Këtë qëllim e shprehte edhe ipeshkvi i Zadrimës, *Frang Bardhi* (1606-1643), në "Parathënie" e Fjalorit të tij me titull, "Dictionarium Latino-Epiroticum" (Romë-1635), "me ndihmë të mbën-janë gjuhënë tanë, që po baretë e po bastard-hobetë saa maa parë të ve; e maa fort me ndihmë të gjithë atyne qi janë në udhënitë t'inë Zot e të Shintesë Kishë Katolike e s'dijnë gjuhënë latine, paa të sijët askush s'munë shërbënjë si dubehtë paa të

nella lingua albanese". Hartues ishte prifti françeskan *Fr. M. Da Lecce*, i cili kishte qëndruar me vite në Shqipëri si misionar. Gramatika përmban edhe një udhëzues për gjuhën me formula përhëndetëse, shprehje frazeologjike, etj. U ribotua disa herë dhe shërbeu deri më shek. XIX si një mjet ndihmës për të mësuarit e shqipes. Libri i fundit në shqip në shek. XVIII ishte "Gjella e Shën Mërisë Virgjër" i *Jul Varibobës*, që u botua nga një shtypshkronjë e panjohur në vitin 1762 në Romë. Nga fundi i shek. XVIII Italia



Shoqëria "BASHKIMI"

### Shkollat e moçme në Kosovë

Pas Paqes së Karllovacit në vitin 1699 ndikimi dhe patronati austriak hetohet fuqishëm mbi të gjithë të krishterët nën sundimin turk dhe sidomos ndaj popullsisë katolike shqiptare. Këtë, Austrisë iu lejua në vitin 1791 të hapte një konsullatë në Shkodër dhe një nënkonsullatë në Durrës, qytete këto nën juridiksionin e kishës katolike. Të drejtat e Austrisë mbi katolikët shqiptarë i njihje edhe Selia e Shenjtë, ku si rezultat u realizua Konkordati në mes të Vatikanit dhe Austrisë të arritur në vitin 1855. Sipas këtij Konkordati, "Vjena pati në kujdes ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve fetare, përkrahjen e klerit ekzisues të urdhrave katolike si dhe përgatitjen e klerit të ri me anën e shkollave brenda dhe jashtë vendit". Numri më i madh i tyre u ndërtua në toka shqiptare. "Prej 240 themelatave katolike nën Perandorinë Turke, 220 ishin vetëm në Shqipëri [...], në shtatë dioqeza katolike: Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Prizrenit, Sapës, Pultit dhe Mirditës. Shkodra si seli ipeshkvornore, ishte qendra e katolicizmit shqiptar". Në këtë aspekt kontribut të rëndësishëm, krahas ndihmës së Austrisë dhe të Vatikanit, kanë dhënë edhe urdhrat kishtare, si jezuitët, françeskanët, salezianët, stigmatinet, servianet, Motrat e mëshirës, etj.

Në mbështetje të burimeve të kohës, që dalin sidomos nga provenienca Perëndimore, kishte para vitit 1840 shkolla katolike për djem e vajza në Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Mësimi në to deri në vitin 1876, zhvillohet në gjuhën italiane, me disa biseda e shpjegime në gjuhën shqipe. Në shkollën e Pejës, një godinë ngji-

tur me Kishën katolike të qytetit kryesisht mësohej për fenë, meqë të gjithë mësuesit ishin priftërinj, si dom Mark Sopi, dom Tom Gusiqi, dom Nikollë Mazreku, dom Shtjefën Krasniqi, dom Zef Harapi etj. Përveç librave në gjuhën latine, italiane, janë përdorur edhe libra shqipe. Në Gjakovë shkolla vepronte që nga vitit 1851 dhe ishte ngritur afër kishës katolike. Kjo shkollë "ishite në një gjendje mesatare, veç sa me i krye nevojat e mësimit". Dhe këtu mësonte dom Pjetër Doda e dom Filip Kanxhi, dom Pjetër Zara, dom Ndue Bytyqi, etj. Në Prizren vepronte shkolla "për të gatue meshtarë". Në këtë shkollë fillimisht punonin disa famullitarë, si dom Simon Lumezi, dom Mazreku, ndërkaq nga vitit 1889 punonin mësuesit profesionist, si Mati Logoreci dhe Lazër Lumezi. U shqua edhe shkolla katolike e Janjevës, që vepronte nga mesi i shek. XVII, shkolla katolike e Stubllës (e hapur më 1846), shkolla katolike në Sheshtan dhe Ljare (nga gjysma e parë e shek. XIX), shkolla e Tivarit e themeluar gjatë viteve 1890-1863. "Në to zhvillohej mësimi, në fillim në italisht, më vonë në italisht dhe shqip, e në fund vetëm në shqip".

### Shoqëria "Bashkimi"

I tërë aktiviteti në zhvillimin e shkollave kërkonte jo vetëm përgatitje intelektuale, por edhe një alfabet për të gjithë shqiptarët. Ky nuk ishte lehtë të realizohet, duke pasur në mend argumentin se në Shqipëri vepronin disa alfabet, si alfabeti i "Bashkimit", "Elbasanit", "Stambollit", "Agimit", etj.

Me nismën e abatis të Mirditës, *Prenk Doçi*, në vitin 1899 ishte themeluar në Shkodër, Shoqëria

"Bashkimi". Para kësaj kohe në tërë Shqipërinë, publikimet e çdo teksti në shqip ishin të ndaluar. Madje edhe publikimet e librave që nuk ishin thjesht me lutje fetare, nga ana e Qeverisë turke konsideroheshin porsivegël politike me qëllime kryenëgritjeje dhe ligjërisht dënohet autori dhe shpërndarësi. Abati, në formimin e shoqërisë letrare të re që u themelua në vitin 1899, mori iniciativën porsivegël një shoqëri fetare dhe pjesëtarët e saj ishin nga radhët e inteligjencës së klerit katolik. Qëllimi ishte hartimi i të parit alfabet shqip. Alfabeti i Shoqërisë "Bashkimi" më vonë pësoi ca ndryshime të konfirmuara edhe në Kongresin e Manastirit. Eshhtë për të vënë re, se Atë Gjergj Fishta u shqua edhe për bashkëthemelues të shoqërisë në fjalë së bashku me një varg burrash të shquar, si Imzot J. Serreqi, L. Mjeda, ky i fundit u nda prej Shoqërisë "Bashkimi" për t'i përkrahur vëllanë dom N. Mjedën, Imzot Gj. Kolecin, L. Gurakuqin, Dom N. Nikajin, Dom D. Kolecin, Atë P. Bardhin, Dom N. Sheldijën dhe Dom M. Çunin. Kjo shoqëri, veç tjerash, hartoi edhe një alfabet të shqipes me shkronja latine, sipas traditës së shkrimtarëve të Veriut, duke përfshirë këtu edhe alfabetin e Pashko Vasës, botoi me dhjetëra libra shqip. Gjatë dhjetë vjetëve të para (1899-1908), pra deri në kohën e mbajtjes së Kongresit të Manastirit, Shoqëria "Bashkimi" botoi 32 vepra, si: libra shkollorë, abetare, libra këndimi, katekizëm, fjalorë dhe bëri përpilimin e teksteve profesionale. Por në realizimin e ndërmarrjeve të tilla u dolën edhe pengesa të natyrave të ndryshme etj. Sipas njohimeve të dom Ndoc Nikajt po i përmendim disa

nga këto botime: "Oroc permbi Abetar shcyp", "Abetar", "Knnojtoria e pare", "Knnojtoria e dyte", "Knnojtoria e trete", "Msimë t'Kshhtëna", "T'nnollunat shëjtë", "Dhëshkroja", "Grammatika", "Numertorja"; Kalëndari "Shcypitari" i viteve 1904, 1905, 1906, 1907, dhe 1908; "Historija e Shcypniis" (D. N. Nikaj), "Historija e Turkiis" (D. N. Nikaj), "Lahuta e Maltsiis" (pjesa e pare dhe pjesa e dyte), "Anxat e Parnasit" (A. Gj. Fishta), "Bulku", "Vargenimi" (L. Gurakuqi); "Mili e Haidhia", "Fjalorhi" (L. Gurakuqi), "Fjalori i gjuhës shcype" (D. D. Kolëtsi), "Blëta e ree" (D. N. Nikaj), "Vjersha e pershpirtshme" (A. Gj. Fishta), dhe "Komsia e Klëri katolik" (A. Gj. Fishta).

E para punë e Shoqërisë Bashkimi, qe caktimi i një alfabeti mbi bazën e shkronjave latine, çështje kjo që ishte vepruar më se një herë nga shkrimtarët e moçëm shqiptarë. Në të vërtetë shkrimtarët e moçëm kishin përdorur për tingujt e veçantë të shqipes shenja krejt të veçanta. "Bashkimi", ndërkaq i zëvendësoi këto me grupe germash thjesht latine, shumicën me ndihmën e germës *h*. Me këtë alfabet u shkruan librat e parë të këndimit, kur gjuha shqipe nisi të hynte zyrtarisht në shkollat e Gegnisë. Përdorimi i teksteve shkollorë të Shoqërisë Bashkimi nuk pati jetë të gjatë. Pa u mbushur tri vjet, ndërroi situata dhe shkollat më 1901 nisën të punonin me alfabetin e Shoqërisë "Agimi". Megjithëse, edhe më tej, jo vetëm shkrimtarët gegë, por edhe toskë, si Fishta, Gurakuqi, Nikaj, Xanoni, Çajupi, Skirò, Asdreni etj, alfabetin e "Bashkimit" e përdorën revistat, fletore dhe libra, si "Elçija"

(1891-), "Albania" e Londrës nuk e ndërroi alfabetin deri në mbyllje (1897-1909); "Albania e Vogël" (1899-1901, Bruksel); "Kombi"; "Shcypitari" i Bukureshtit; "Perlindja e Shcypetarvët"; "La Nazione Albanese" (në pjesën shqype Romë); "Shcypenia e ree"; "Shpnes e Shcypeniis" (Ragusë); "Toska"; "Besa"; "Albanitorja" (Belgrad); Lajmtari i Scypniis (Romë); "Pellazgu"; Asdrën ("Réze Djelli"); Chajup ("Baba Tomorri"); Shoqëria "Dija" (Kalendari 1906 per gjys; Kalendari 1907 krejt); Karta dhëshkrimtare e Shcypniis; G. Schiro; G. Jakova; Sotir Pétsi (Méthoda per te mesuar anglishtnë); Fan Noli në disa libra kishtare, dhe Atë Shtjefën Gjeçevit.

Me nismën e jezuitit Dom Ndre Mjedës në vitin 1901 u themelua në Shkodër Shoqëria "Agimi". Me këtë alfabet u botuan dhe kalendari "Dija" (Vjenë më 1906), fletorja "Dashamiri" në Trieste, etj. Alfabeti i "Agimit" ka vazhduar rrugën e përgjithshme, të cilën e ndiqnin një pjesë e albanologëve me rastin e transkribimeve të teksteve, si Brugmann, G. Mayer Pedersen, etj.

Po përfundojmë duke konstatuar, se pjesëtarët e klerit katolik shqiptar, përveç traditës së bujshme në lëvrimin e gjuhës shqipe nga fillimet e saj në mesjetë, u shquan edhe me kontribut të rëndësishëm në Kongresin e Manastirit më 1908, ku u spikat sidomos erudicioni i Atë Gjergj Fishtës, dom Nikollë Kastorit, dom Ndre Mjedës, Luigj Gurakuqit e ndonjë tjetri, u arrit kompromisi ndërmjet alfabetëve të shoqërive shqiptare pa marrë parasysh orientimin fetar, ku si rezultat shpallët ky alfabet që është në përdorim edhe sot.

## shpallime historike

## Gjurmëve të Gjeçovit nuk u shihet skaji

■ SHKRUAN:  
Nikollë KËRHANAJ

At Shtjefën Gjeçovi për 55-vjet të jetës, me bashkë-veprimtarët e kohës së vet, krijoi një epokë të artë për kulturën e traditën kombëtare me binomin fishtian – për Fe e Atdhe.

Në vitin e ardhshëm (2009) mbushen 135 vjet të lindjes dhe 80-vjet të vrasjes mizore të tij. Andaj, paraprakisht është me interes t'i vlerësojmë botimet, publikimet e studimet e ndryshme me përmbajtje shkencore që bëjnë fjalë për një personalitet siç është Gjeçovi.

Për hir të saktësisë dhe akrit të fundit të jetës, punës dhe flijimit të vetvetes, që Gjeçovi përjetoi në ditët e fundit të punës në Zym, do t'i radhisim disa pasaktësi në punën gjurmuese të punëtorëve të nderuar në fushën e shkencës, të kulturës, të trashëgimisë e të historisë kombëtare të përgjithshme, e të atërit Shtjefën Gjeçovit në veçanti.

- Në Simpoziumin Ndërkombëtar, mbajtur në Zagreb, më 18 mars 2007, organizuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci dhe Këshilli i Pakicës Kombëtare Shqiptare të qytetit të Zagrebit, në temën: "At Shtjefën Gjeçovi dhe Kanuni", në mes tjerësh, prof. dr. Zef Mirdita u paraqit me kumtesën "Patër Shtjefën Konstantin Gjeçovi-Kryeziu: – Jeta dhe vepra", ku në mes tjerash, shkruan: "...Disa mendojnë se është e mundur se e ka vra Frokua (Frok Peca), nëpunës komunal (postier i Prefekturës së Zymit)... shkruar sipas gazetës "Politika" të Beogradit (15. X. 1929).

- Në gazetën e përditshme "Kosova sot" të datës 23 prill 2008, në f. 12 "Fejtoni"(16), autori Prof. Dr. Hakif Bajrami në mes tjerash shkruan se si u vra Shtjefën Gjeçovi dhe se si mbreti Zog e dekoron Patrikun e Beogradit me "Shenjën e Madhe të Skënderbeut" dhe duke shpërguar rrethanat e kohës dhe të vrasjes së At Shtjefën Gjeçovit, jep edhe këtë shënim: "Në rrugë me fratin kishin qenë edhe Mark Zefi dhe Prenk Deda. Vrasësit ishin gjurmuar, por meqë dihet kush ishin, ata nuk ishin zbuluar."

*Të dhëna plotësuese:*

Pasi ditën e diel, më 13 tetor u "ftua" përmes xhandarmërisë së Zymit, të nesërmen, ditën

e hënë, më 14 tetor 1929, dihet saktësisht se bashkudhëtarë me atë Shtjefën ishin: Frok Peci Berisha (42-vjeçar, postier i Prefekturës në Zym) dhe Sherif Kërhani (rreth 20-vjeçar nga Gurazupi i Hasit, korrier i shkollës katërklasëshe, i cili e zëvendësoi kushëririn e vet Vahap Kerhanin, të cilin e kishin rekrutuar ushtar të SKS-së).

Gjeçovi kishte shkuar në Prizren sipas "ftesës" dinake, mashtruese e të montuar të kryetarit të Prefekturës e të Rrethit – Mita Bogdanoviq.

Të hënë, më 14 tetor u vra, ndërsa të mërkurë, më 16 tetor 1929, u bë ceremonia mortore e varrimit të martirit të fesë e të kombit nën udhëheqjen e ipeshkvit Dr. Ivan Franjo Gnidovec, në bashkëmëshim të At Lorenc Mazrreku – Pejë, don Shtjefën Krasniqi – Velezhë, don Luigj Gashit – Smaq, At Tomë Xhajes – Zllakuqan, Serafin Mazrreku e Nikollë Mark Balës nga Peja.

#### Rrëfimi i bashkudhëtarit të Gjeçovit për ditën e vrasjes

Për të vërtetuar të kundërtën e asaj që rrëfen Hakif Bajrami mbi personat që ishin me Gjeçovin, po japim rrëfimin e Sherif Kërhanit, bashkudhëtarin e natës së kobshme kur u qëllua për vdekje vetë i madhi Gjeçovi.

Gjatë kthimit, deklaroi Sherif Kërhani, derisa kalonim Landovicën (në Zarojë) hetuam nëpër prozme disa persona të dyshimtë që fshiheshin. Por kaluam. Po ashtu, duke kaluar urën e porsafilluar së ndërtuar në Krajk, u dukën nja dy-tre njerëz të veshur në të zeza (pita e dytë). Ne që të tre, duke veshur përmes tinëzish, kaluam Drinin për urën dhe iu ngjitem shpatit përjetë përmes vreshtave të Krajkut. Gjeçovi nuk pushonte duke na rrëfyer për të kaluarën tonë të lavdishme, por ne hetonim një dozë frike si parandjehësi kabi. E lutëm të kërkojmë në Krajk një kali për të udhëtuar më lehtë, por ai nuk pranoi. Bëmë një pushim në rrafshin e parë mbi fshatin Krajk. Vazhduam rrugën. Në Rrezinë të Vreshtave të Zymit u paraqit pita e tretë. U dëgjua disa zëra provokues në adresë të frarit, të cilëve atë Shtjefni iu përgjigj: "Mos lueni n'armë burra!" Ne u fshëm pas llugave. Krisi pushka. Gjeçovi u qëllua në kokë, ra përdhe. Hijet e zeza iu afruan kufomës dhe shtinë edhe tri herë mbi të ndjerin dhe ikën. U morim vesh; Frokua të shkojë për ta lajmëruar Prefekturën dhe Poskomandën e Xhandarmërisë në Zym, ndërsa unë (Sherif Kërhani) ta ruaja kufomën. Natë vit (1929) punëtorët

ndërtonin rrugën me kalldrëm Krajk-Zym. Pas një ore erdh nga Zymi Tunë Tunë Pecollaj, pandur i Zymit, për të më ndërruar. Unë shkova në shkollë, ku edhe punoja. Xha Sherifi rrëfen përjetimet e veta pas vrasjes së Gjeçovit...

Sipas të gjitha gjasave, kanë qenë tri pita të organizuara: Një në prozme të Landovicës, e dyta në kalimin e Drinit përmes urës në Krajk dhe pita e tretë e kobshme në Rrezinë të Vreshtave të Zymit.

Në shkrimin fejonistik të prof. dr. Hakif Bajramit përmenden emrat e dy bashkudhëtarëve, të Marka Zefit dhe të Prenk Dedës. Një konstatim i tillë nuk qëndron, andaj edhe nuk mund të jetë i pranueshëm. Megjithatë, duhen shikuar e analizuar rrethanat tjera. Çka do të thotë se pas 50-vjetësh, mund të sqarohen, publikohen e të ndriçohen edhe shumë paqartësi e situata të mjegulluara për çështjen – Gjeçovi.

#### Si u zhduk muzeu i Gjeçovit në Shkodër (?)

Nëntoka shqiptare dhe muzeutë ruajnë kulturën, trashëgiminë dhe historinë e popujve, andaj edhe janë argumenti më i fuqishëm kombëtar.

Siç ka qenë e njohur, por edhe në shkrimin e fundit të prof.

dr. Jahja Drançollit (po në këtë gazetë – revistë, dhjetor 2007), duke bërë fjalë po për At Shtjefën Gjeçovin, në fund të punimit thotë se Shkopi i Gjeçovit ruhet edhe sot në Muzeun e Gjeçovit në Shkodër. Në të kundërtën, fatkeqësisht, Muzeu i dikurshëm i Gjeçovit në Shkodër sot nuk ekziston (?) Realisht thonë se askush nuk di se ku janë 499 eksponate të Muzeut të Gjeçovit, me përjashtim të shtagës (shkopit) së Gjeçovit, që gjendet në tavanin e Bibliotekës Françeskane të Gjuhadrilit në Shkodër, duke shtuar se atë e shoqëron edhe shkopi i pleqërisë së Gjergj Fishtës, i cili lëngonte në njëren këmbë.

Gjeçovi mbante shkop për histori, ndërkaq Fishta mbante shkop në pleqëri.

Shpresojmë se në Zym do të formohet "këndi i muzeut të Gjeçovit", por planifikohet që të ndërtohet edhe "Çela e Gjeçovit", ku punoi ai së bashku me sivëllezërit e vet.

Edhe në aktin e shkruar të vdekjes dhe varrimit të Sh. Gjeçovit në "Librin e të vdekurvet" në Zym (tash në Zyrën e Vendit, të K. K. Prizren) gjenden shënime e disa të dhëna (latinisht) siç përmenden i ati i Gjeçovit-Mata (Mateja) dhe e ëma ANA GUGA nga Prizreni e disa të dhëna tjera.



Shtëpia e lindjes së Ana Gugës (nënë së Gjeçovit) në Prizren



# Shqiptarët katolikë në/dhe marrëveshjet diplomatike – Konkordatet – të Vatikanit me Jugosllavinë (III)

■ SHKRUAN:  
Zef AHMETI

## VI. Përndjekja në emër të komunizmit

Pas Luftës së Dytë Botërore, komunizmi në disa vende, për ta marrë pushtetin, i është dashur kohë më e gjatë për dallim me Jugosllavinë dhe Shqipërinë, ku praktikisht me (ç)“lirim“ monopoli i pushtetit bie në duart e komunistëve. Marrja e pushtetit nga komunistët në Jugosllavi, natyrisht se nuk ishte bërë ashtu pa ndonjë mundim të veçantë. Në Jugosllavi vlerësohet se marrja e pushtetit nga komunistët është përcjellë me një gjakderdhje. Viktimat që bien si rezultat i kalimit të pushtetit në dorën e komunistëve, arrijnë shifrën gati një milion. Kjo për shkak të disa luftërave civile që bëhen duke u përcjellë me konflikte etnike, ideologjike dhe religjioze, dhe këto konflikte kanë shkakuar më shumë viktima se sa vetë Lufta e Dytë Botërore në Jugosllavi. Dhe në shumicën e rasteve viktimat kanë qenë civilë, fëmijë, pleq e gra. Një skenë e ngjashme terrori vlerësohet edhe nga zhvillimet në Shqipëri, ku terrori komunist i përkrahur nga „shokët“ jugosllavë persekutonte qytetarët.

Qëllim i forcave komuniste ishte shkatërrimi i shoqërisë civile dhe i strukturave të tilla, me çka pretendohet që të arrihet një kontroll absolut mbi shoqërinë e që kishte për qëllim të mënjanojë çdo kontroll të shoqërisë civile ndaj shtetit. Këtu numërojmë p.sh. shoqatat, Kisha, sindikatat, qeveritë lokale dhe atyre të regjioneve (self-government), partitë tjera politike dhe së fundi edhe mendimet e lira publike.

Dhe si rezultat i kësaj politike ata (për)ndjekin me format e ndryshme udhëheqës e aktivistë të partive tjera, sindikatave, kishës, gazetarë, shkrimtarë etj.. Në të vërtetë, në shënjestër të komunistëve kanë qenë figurat kryesore të organizatave civile dhe të shoqërisë civile. Forcat komuniste për ta siguruar push-

tetin e tyre e duke qenë edhe të dëgjueshëm përballë Bashkimit Sovjetik, shkatërruan çdo kontakt dhe lidhje të shoqërisë civile që i kishte pasur me «jashtë» si katolikët, protestantët, socialdemokratët etj. Kështu nuk përndiqen vetëm aktivistët e brendshme që nuk i „bindeshin“ linjës komuniste, por edhe atyre strukturave që tradicionalisht kishin marrëdhënie intensive me botën.

Armiku më i madh i komunizmit është vlerësuar përherë Kisha Katolike dhe shërbyesit e saj. Kështu, ky subjekt persekutohet në mënyrë permanente, përndiqet pamëshirshëm me format më brutale dhe të justifikuar dhe me procese të montuara. Për ta arritur qëllimin e ndikimit të shtetit komunist mbi shoqërinë dhe për ta reduktuar atë të kishës në shoqëri, tentojnë që atë ta instrumentalizojnë për t'i arritur qëllimet e tyre, komunistët aplikojnë një metodë të kombinuar si represaliet, korrupsionin, përndjekjen e klerit. Ndërsa një përndjekje e parë e këtij lloji ndaj Kishës Katolike nga komunistët, edhe në literaturën ndërkombëtare vlerësohet se u bë në Shqipëri. Për dallim nga situata e Kishës Katolike dhe Kishës Greko-katolike (Uniate) në disa vende të Ballkanit, Kisha Ortodokse heshet përballë terrorit komunist, ndërsa udhëheqësit e tyre aranzhojnë me këtë regjim, çka solli si rezultat që kishat e tyre të mos mbyllën dhe kleri ortodoks (popët) të mos përndiqen.

## VII. Pozita juridike e religjioneve në RSFJ

Pas LDB-së marrëdhëniet mes Kishës Katolike dhe Ortodokse kanë qenë shumë të rënduara. Ato në atë kohë ishin më tepër të koncentruara në riorganizimin e tyre dhe ndërtimin e strukturave të reja dhe ndërtimin e objekteve fetare të shkatërruara gjatë luftës. Edhe raportet mes Kishës dhe shtetit bëhen të ndjeshme. Para luftës, edhe pse nuk kishte fe zyrtare (kushtetuta 1921 dhe 1931), kisha (sidomos ajo ortodokse) nuk ishte edhe e ndarë

plotësisht nga shteti. Duke pasur parasysh lirinë e religjioneve dhe popujve në RSFJ-në e pasluftës, liria e religjioneve (feve) nuk ishte e rregulluar me ligj. Me kushtetutën e vitit 1946, më pastaj edhe të asaj të vitit 1963, bëhet „ndarja e plotë“ mes Kishës dhe shtetit. Një hap tjetër në këtë drejtim bëhet edhe me nxjerrjen e ligjit për rregullimin e pozicionit të bashkësive fetare në vitin 1953. Këtë ligj nuk e kishte pranuar Kisha Katolike. Kisha akuzohet kështu ajo nuk ka pranuar për arsye të disa „pikëqëndrimeve parimore“ të saj, se ajo e kishte refuzuar të drejtën e shtetit që të rregullojë një çështje të tillë.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1962 për „harmonizimin“ e disa pikave me karakter federativ, pasojnë edhe disa ndryshime „harmonizuese“ (1965) për pozicionin juridik të bashkësive fetare. Ligji që deri në këtë kohë kishte mundësuar mbylljen e shkollave fetare dhe të mësimi fetar në rast të „keqpërdorimit“ për kohë të caktuar, me këto ndryshime marrin kalje më „liberale“.

Në RSFJ kompetencat për rregullimin e çështjes fetare kanë qenë në kompetencat e federatës. Ndërsa njësitë tjera të federatës kishin të drejtë të rregullojnë ato fusha që nga ligji federativ nuk ishin të rregulluara. Me gjithë kufizimet nga sistemi komunist, religjioni dhe përkatësia kombëtare janë shkikuar nga njerëzit si një e vetme. Kjo arsyetohet me faktin se Kisha ishte mbrojtëse e popullit gjatë historisë, zakoneve, artit popullor, e para se gjithash, ka ndihmuar në ruajtjen e identitetit kombëtar, ku shpesh përballë sundimeve të huaja, qëndronin udhëheqës të vetëm legjitimë nga populli. Ndërsa religjioni gjatë sundimit të komunizmit në RSFJ ofronte alternativë përballë ideologjisë komuniste.

Çështja e fesë në RSFJ ka qenë e rregulluar nëpër ligje të ndryshme që nxirren pas LDB-së. Ligjet që kanë rregulluar këtë fushë ishin:

- *Kushtetuta e RSFJ-së* (neni 33, 39, 41 e në veçanti neni 46 që siguronte lirinë e besimit por njëkohësisht edhe duke kufizuar këtë të drejtë me ndalimin e përzierjes së feve në politikë);
- *Ligji për rregullimin e pozicionit juridik të bashkësive fetare*. Ky ligj rregullonte të drejtat dhe detyrimet e bashkësive fetare dhe ishte i ndarë në katër pjesë: pjesa e përgjithshme (§ 1-12), mbrojtja e ceremonive fetare (§ 13-17), trajtimi i mësimi fetar (§ 18-20), dhe pjesa e katërt që sanksionon sjelljet penale (§ 20a-21);
- *Ligji i administratës federative të Jugosllavisë* (neni 35-42);
- *Ligji për organet administrative të federatës së Jugosllavisë* (neni 24 dhe 28);
- *Ligji për ndryshime agrare dhe kolonizim*. Me anë të këtij ligji dhe ndryshimeve agrare të vitit 1945 preken edhe pasuritë e bashkësive fetare dhe objektet e tyre (neni 3, 8). Ky ligj ndryshohet në vitin 1958, por merr pikat e ligjit të vitit 1945 dhe zgjerohet me disa nene tjera (§ 3, 11, 74). Ky ligj kishte për qëllim, pos të tjerash, edhe kufizimin e pasurive të bashkësive fetare;
- *Ligji për mbrojtjen e monumenteve* ishte nxjerrë, si thuhet, për “mbrojtjen e pasurive dhe monumenteve fetare” (§ 7, 8, 10, 17);
- *Ligji për martesën* në § 34 lejonte martesën në kisha sipas rritit fetar, ndërsa kushtëzohet me lidhjen martesore paraprake të organet civile;
- *Ligji penal* që sanksiononte nxitjen e urrejtjes fetare të popujve dhe popullsisë të Jugosllavisë (§ 119, 311, 312, 313) dhe
- *Ligji për sigurimin pensional* rregullonte statusin e pensionistit edhe për klerikët dhe punëtorëve tjerë në kishën ortodokse maqedone e serbe asaj baptiste dhe fesë islame. Për dallim nga këto, Kisha Katolike nuk kishte lidhje ndonjë marrëveshje të tillë për sigurim pensional në kuadër të

federatës. Ka ekzistuar vetëm marrëveshja e bërë në kuadër të Republikës së Sllovenisë dhe Kishës Katolike në këtë republikë.

Në kuadër të këtyre ligjeve ishin ngritur edhe komisionet në republikat e Jugosllavisë për çështje të feve (*Komisija za vjerska pitanja*), po ashtu në kuadër komunash edhe referent për çështje të fesë që quheshin si *vjerski referent*, për të rregulluar “marrëdhëniet mes Kishës dhe shtetit” dhe për t’u “përkujdesur” që të aplikohen ligjet për fetë.

Në RSFJ pra kishte disa ligje që rregullonin çështjen e fesë në atë kohë. Edhe pse prej vitit 1966 vërehet një përmirësim i gjendjes së Kishës Katolike në Jugosllavi, ku ishte ndjenja se Kisha gëzonte liritë dhe të drejtat bazuar në lirinë e besimit dhe mendimit, ajo ishte e kufizuar që të vepronte vetëm në objektet e saj. Propaganda antifetare nuk kishte pushtuar asnjëherë, ndërsa kjo bëhet edhe më intensive, posaçërisht kur mendohej se Kisha tashmë i gëzon të gjitha të drejtat, porse këto të drejta duhet të kufizoheshin nga pushteti komunist që të mos “humbin” kontrollin dhe pushtetin absolut duke filluar me propagandë intensive nëpër shkolla publike. Kjo fushatë antikishtare e shqetëson shumë edhe Konferencën Ispeshkore të Jugosllavisë. Në mbledhjen e datës 11 tetor 1973 Konferenca shpreh shqetësimin e saj për sulmet e intensifikuara e të pabaza ofenduese që në atë kohë bëheshin edhe nëpër media. (*Albert Rauch, Kirchen und Religionsgemeinschaften, në: Jugoslawien, Klaus-Detlev Grothbusen (ed.), Südosteuropa-Handbuch, völl. I, Berlin 1987, fq. 347*). Ndërsa ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 nuk sjellin ndonjë ndryshim në raport mes Kishës dhe shtetit, përveç se që nga viti 1971 kërkohej që në mënyrë intensive të përfordhet edukimi marksist nëpër shkolla ku edhe fillohet që sa më shumë që është e mundur të kufizohet mundësia për ndërtimin edhe të kishave.

(vijon në f. 19)

# Lorenc Antoni – pionier i muzikës shqiptare në Kosovë (II)

■ SHKRUAN:  
Akil Mark KOCI / Londër

## Kushtet dhe rrethanat e krijimtarisë

Muzika korale ishte krijimtaria kryesore e Lorenc Antonit, si shprehje artistike e si vetëdije, e bazuar në tradicionale. Kjo muzikë na vjen në atë kohë si ndjeshmëri e observimeve të shkruara në përvijim të kohës pak absurde, sepse çdo fillim konsiderohet si i pamundshëm për të realizuar projekte të menduara mirë e për një zhvillim më të hovshëm dhe më të bollshëm muzikor. Si krijues, si intelektual, si njeri, me një diskurs strategjik në realizimin e qëllimeve profesionale, gjithnjë ndeshje në atë kohë me injorancën dhe me injorantët

mund përshkruhen edhe si fantazi e parealizuar.

Në fillim të vitit 1946 në rrafshin kulturor dhe arsimor në Kosovë situata ishte tejte e rëndë. Nuk do ta teproja nëse them se vetëdija e njerëzve tanë, për sa i përket asokohe muzikës, ishte më tepër injoruese dhe denigruese. Menjëherë pas lufte dukeshin prirjet e hakmarrjeve ndaj "armiqve të popullit" dhe çdo tentim i krijimit të një atmosfere kulturore karakterizohej me një amorfitet që ishte transparente në çdo mblidhje të "Frontit Popullor", duke i dhënë karakter armiqësor. Kështu në këtë atmosferë ishte vërtet vështirë të punohej e aq më pak të krijoheshin kushte për një atmosferë njerëzore, artistike dhe humaniste. Është e vërtetë

në atë kohë shkroi edhe kompozimet pak më serioze se ato të kohës rinore e që ishin të shumtën me karakter të pasur lirik, me një synim dhe shprehje të qartë në drejtim të përfshirjes sa më të madhe të melosit shqiptar.

## Këngët e para të Anton Lorencit në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore

Këngët e para që harmonizoi, ishin "Na ka dalë nusja e mirë", "Ani mori nuse", "Ani moj Hatixhë", "Kur më del në derë", "Çka po të lypha balli moj" dhe shumë të tjera. Këto këngë, po të shikohen me syrin e një kritiku a një muzikologu, do të vërejmë se pasqyrojnë realitetin e vlerave si realizime modeste të shprehura me ndjenjë dhe emocione krijuese, kurse prezenca e vlerave artisti-

mund ta shikojë vetë autori, sepse brenda këtyre këngëve mund të hasim edhe në aso zgjidhesh si nga aspekti melodik, si nga ai ritmik dhe harmonik. Lorenc Antoni po i tejkalonte konceptet e krijimeve amatore, po jepte krijime të rëndësishme që e begatojnë krijimtarinë e muzikës korale ndër ne.

## Kompozime korale – për të Lumen Nënë Terezën

Në këtë shkrim do të ndalem në dy këngët kushtuar të madhes Nënës Terezë, gjegjësisht këngën "Lamtumirë" në tekstin e Gonxhe Bojaxhiu, Nënë Terezës, "Nëna përvojtnië" në tekstin e Arben Komanit si dhe këngën e parë "Në breg të liqenit" sipas poezisë së Hil Mosit, kompozuar enkas për një akademi organizuar me

zikës, qofshin ato popullore, të lehta apo serioze. Të shumë janë ata pa dallim feje apo kombësie që i kënduan kësaj shenjtëreshe të rrënjëve tona.

Kompozitorët shqiptarë të të gjitha trevave, kompozuan shumë vepra të muzikës klasike siç janë: Lorenc Antoni, Vinçenc Gjini, Akil Koci, Zeqirja Ballata, Rrauf Dhomi, Gjon Gjevelekaj, Gjergj Kaçinari, Bernardina Mjeda dhe të tjerët si dhe shumë kompozitorë nga Shqipëria, Arbëreshët e Italisë, Maqedonia dhe vendet e tjera.

Siç e thashë edhe më lart, në vazhdim do të fokusohem në tri këngët e kompozitorit tonë, duke i analizuar ato shkurt. Lorenc Antoni kompozoi këngën "Në breg të liqenit", si nxënës i gjimnazit të Shkupit, sipas tek-



Kori i katedrales më 9 qershor 1947

që e rrethonin dhe në çdo moment pengonin në realizimin e qëllimeve të tij fisnike, edhe pse preferonte me këtë art të bukur humanizmin e vërtetë njerëzor. Është e kuptueshme që duke u ndeshur në këso pengesash, refleksionet shumëdimensionale

se kësaj i kanë ndihmuar edhe forcat regresive të asaj kohe, të cilat këtë lloj muzike e shihnin si dyshim, frikë dhe mosbesim. Me gjithë pengesat e shumta në të cilën ka hasur ky krijues dhe erudit, ai arriti të organizonte një jetë modeste muzikore dhe mu-

ke në masë të madhe e arsyetonte pozitivistin krijimtarinë muzikore të këtij autori. Këto krijime në formë të stilizimeve, përpunimeve, harmonizimeve janë shprehje pragmatike, të arritura pa pretendime që ato të jenë të vështira për koret amatore. Këtë më mirë

25 mars 1928 për qëllime humanitare për të varfër, të kënduar nga Gonxhe dhe Age Bojaxhiu.

Përveç krijuesve të letërsisë, artist pamor dhe atij të filmit, edhe krijuesit muzikorë, kompozitorët, kanë dhënë kontributin e tyre modest me vepra të mu-

stit të Hil Mosit që u këndua nga motrat Gonxhe dhe Age Bojaxhiu, me 25 mars të vitit 1928 në një akademi organizuar për qëllime bamirëse dhe humanitare pikërisht për të varfër. Kjo këngë për dy zëra, e kompozuar prej një djaloshi, ishte edhe

“ Muzika korale ishte krijimtaria kryesore e Lorenc Antonit, si shprehje artistike e si vetëdije, e bazuar në tradicionale. Kjo muzikë na vjen në atë kohë si ndjeshmëri e observimeve të shkruara në përvijim të kohës pak absurde, sepse çdo fillim konsiderohet si i pamundshëm për të realizuar projekte të menduara mirë e për një zhvillim më të hovshëm dhe më të bollshëm muzikor. ”

“ Është një kompozim i inspiruar me një tekst të vetë Nënës Terezë, ku Antoni zbulon jo vetëm me koncizitet aspektin shprehës, por edhe atë formal, koncizitetin tingëllor të ndërtuar në motivet e melosit tonë. ”



Themelimi i korit të katedrales së Prizrenit, viti 1946

kompozimi i tij i parë. Nuk është ndonjë këngë me vlera të larta artistike, por shënon fillimin e një krijimtari të një djaloshi, i cili na prezantohet si kompozitor i talentuar. Kënga për dy zëra me lëvizje të zërave që kumbojnë pastër me një tingëllim të çiltër, të themi hyjnor, strofike, e shkruar për Sopran dhe Alt, hyn në kategorinë e këngëve për sa i përket formës dypjesore.

Kompozimi tjetër në tekstin e të lumes Nënës Tereze “Lamtumirë”, me rastin nisjes për udhëtim për Indi (09.12.1928), është kompozim shumë më serioz dhe më interesant në katër zëra, sopran, alt, tenor dhe bas dhe ka një formë A, B, A që do të thotë tripjesore. Teksti fillon kështu:

*Po le shëpinë zemër fanar  
Vendlindje e fare fis  
Po vet në Bengal  
Dergjet vararë  
Atje në të largët Vis.  
Refrëni:  
Nënë e dashur lamtumirë  
Ju la shëndet o miqtë e mi  
Më djeq o një fuqi e dëlirë  
Drejt të përflakurës Indi.*

Pra, kjo poezi e Nënës Terezë e inspiroi Lorenc Antonin që ta

bëjë një kompozim të muzikës korale, i cili nuk ka përfjetuar ende ekzekutimin e parë, dhe as vetë nuk jam në gjendje ta shpjegoj pse, por të paktën është botuar në librin kushtuar Nënës Terezës “Lule për Nënë”. Për sa i përket anës tekstuale është mjaft e gjatë, e cila shpreh tërë atë gëzim dhe shpresë që të qëndrojë në misionin që e ka zgjedhur dhe në atë poezi ajo shprehet kështu:

*Pranoje, këtë flijim o Zot  
Dëshmi e përbetimit,  
Ndihmoji gjallesës Tënde sot  
Që nderin do ta madhëroj!  
Si shpërblim, të lus o Hir,  
O Ati i ynë plotë mirësi  
Të më japësh vetë atë shpirt  
At shpirt që -veç ti e di.*

Për sa i përket anës muzikore, them se është tripjesore dhe në këtë vepër hasim në një harmoni të plotë mes tekstit dhe muzikës; anon kah transformimi artistik, kurse strofat e saj nuk janë të punuara në mënyrë të ndryshme, por përsëritëse me të njëjtën muzikë në të gjitha nëntë strofat.

Pra, kemi të bëjmë me një kompozim të i inspiruar me një tekst të vetë Nënës Terezë, ku Antoni zbulon jo vetëm me

koncizitet aspektin shprehës, por edhe atë formal, koncizitetin tingëllor të ndërtuar në motivet e melosit tonë. Edhe pse pa e cituar asnjë temë, ndihet fryma e saj që paraqet një shtjellim të veçantë muzikor, bazuar në invenicionin dhe imagjinatën e tij dhe kështu me sukses e përfundon këtë këngë për korin mikst.

Kënga e tretë që titullohet “Nëna e përvujtisë”, dallohet nga dy këngët e para, sepse nuk është kompozuar si ato të parat, por për zë dhe piano, që paraqet një risi, sepse me mjetet thjesht artistike konstruktin një kompozim. Edhe pse është kompozuar në suazat e muzikës romantike, është një kompozim me vlerë të suksesshme, duke e rivendosur një unitet në mes të zërit dhe pianos, i cili nuk është spontan, por kërkon përmes tekstit të Arben Komonit kuptimin dhe zberthimin objektiv të domethënies tekstuale. Edhe pse ka vetëm dy strofa, paraqet një realizim të mirë për të cilën Antoni përmes muzikës kërkon spiralen gjenetike si porosi universale me vlera të qëndrueshme tingëllore, që, pa ndonjë narracion të caktuar, i përmbahet kriterit të interpretimit artistik.

Edhe pse është ndër këngët e para të tij për zë dhe piano, Antoni na sjell një kompozim që ka vlerën artistike, kurse teksti fillon kështu:

*Nëna e jonë Tereze,  
Nëna e botës mbarë,  
Shëron të smurë  
Gurin e kthen në arë.  
Nëna e jonë Tereze,  
Gjithmonë zemër butë,  
I ngjan Jezu Krishtit  
Me zemër të përvujtë.*

Për nga aspekti i shqyrtimit të këtyre këngëve brenda kufijve të estetikës, ato nuk mbrartin dhe nuk kanë ndonjë peshë të madhe artistike, por janë kompozuar me një ndjenjë të veçantë, si monolog i brendshëm krijues, me shumë dashuri për një ikonë emblematike, humaniste të madhe, shenjtëreshë shqiptare, pa metafora. Edhe pse Aristoteli për metaforën thotë se ajo është mbretëreshë e figurave, megjithatë ajo paraqet në vetvete një metaforë si figurë e shquar, e cila ligjëronte dashuri nëpër botë dhe u bë kult i dashurisë së përbotshme dhe i mileniumit tonë artistik. (fund)

(Nëntitujt janë të redaksisë)

(vijuar nga f. 17)

Kisha Katolike, me gjithë kundërshtimet që i bën në kuadër të Jugosllavisë, që disa çështje të rregulloheshin sipas kërkesave të asaj kohe; pas keqësimit të marrëdhënieve mes Vatikanit dhe Jugosllavisë, ato normalizohen në vitin 1966 me nënshkrimin e protokollit mes Selisë së Shenjtë dhe RSFJ-së. Normalizimi i marrëdhënieve vijon pas bisedimeve që zhvillohen mes përfaqësuesve të të dyja palëve në Romë më 26 qershor dhe 7 korrik 1964, në Beograd më 15-23 Janar dhe prej 29 maj deri më 8 qershor 1965 dhe përsëri në Romë prej 18-25 prill 1966. Kurse protokollin nënshkruhet më 25 qershor 1966, në bazë të së cilit (ri) fillojnë marrëdhëniet diplomatike Vatikan-Jugosllavi. Ky protokoll edhe pas shkatërrimit të kësaj federate e deri më sot, marrëdhëniet diplomatike mes Serbisë dhe Malit të Zi dhe Selisë së Shenjtë i bazon në këtë protokoll, meqë Serbia mbahet se është trashëgimtare e RSFJ-së, e për këtë arsye edhe ky akt është ende valid.

Tani, me shpalljen e Pavarësisë së Kosovë dhe njohjes së saj nga gjithnjë e më shumë shtete, është hapë edhe mundësia për lidhjen e një konkordati mes Republikës së Kosovës dhe Vatikanit. Kjo marrëveshje do të ishte edhe një njohje de facto dhe de jure e Republikës së Kosovës nga ana e Vatikanit. Dhe kjo për arsyen e vetme logjike juridike, se Konkordatet lidhen vetëm mes shteteve dhe Vatikanit. Ndoshta në agjendën e punës së Ipeshkvit të Kosovës ka zënë vend edhe kjo pikë, mbase, ndoshta do të ndryshojë tani statusi edhe i Administratës Apostolike i Kishës Katolike të Kosovës që e ka tani.

Në shtetin e ri të Jugosllavisë, e në veçanti pas Koncilit II të Vatikanit, me të cilin fillojnë edhe kontaktet e para ekumenike në mënyrë intensive mes Kishës Ortodokse dhe Kishës Katolike, por që më vonë zbehen shumë, fillon edhe organizimi i Kishës Katolike në kuadër të shtetit të Jugosllavisë. Ipeshkvijtë vendosin të organizohen në një Konferencë Ipeshkvore të Jugosllavisë me qendër në Zagreb. Ipeshkvijtë takoheshin dy herë në vit në mbledhjet e tyre plenare ku shkëmbejnë informacionet, trajtonin çështjet pastorale, harmonizonin vendimet kishtarë etj. Konferenca Ipeshkvore e Jugosllavisë kishte edhe grupet punuese të organizuara në komisione për fushat që kishin të bënin me çështje territoriale, liturgji, ekumenizëm, besim, apostollatën e laikëve, katekizëm e rregulltarë, media, për seminaristë, klerin etj. Kisha Katolike ishte e ndarë në 5 Provinca kishtarë, 21 Dioqeza dhe 3 Administrata Apostolike. Në këtë kohë Ipeshkvia Shkup-Prizren kishte 19 famull, 26 prifta dioqezanë dhe 8 prifta rregulltarë. Atëherë botohej edhe revista e njohur “Drita” që publikohej një herë në muaj me 3000 ekzemplarë. (fund)



## TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

*Jam mik i Kishës Katolike  
dhe dua ta ndihmoj  
ndërtimin e Katedrales  
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës  
të dashur, ju mundësojmë ta  
jepni kontributin përmes xhi-  
rollogarive bankare.

### Faleminderit!

**Raiffeisen BANK**  
Kosovo J.S.C.  
Prishtina, Kosovo  
SWIFT code: RBKORS22

**Adm. Ap. e Prizrenit**  
**Numri i llogarisë:**  
EUR: 1501 090000 1990 20  
USD: 1501 090000 3765 30  
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

## ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë "Dritën"** (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: \_\_\_\_\_

Mbiemri: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Qyteti: \_\_\_\_\_

Kodi postar: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: [revistadrita@hotmail.com](mailto:revistadrita@hotmail.com) ose [revistadrita@yahoo.com](mailto:revistadrita@yahoo.com).

# DRITA

**E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE**  
Prizren • Maj 2008 • Viti XXV • Nr. 5 (164) • Qmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 35FR, SHBA \$2.50

**TURNIRI DIOCEZAN I RINISË**  
Sporti bashkohor rinorë e geshkuvë  
sonë  
Nga: (Shtet: ENGLAND ZARA)

**VIZITA E IPESHKËVITË SHKËPËRISË NË VIZITË "AD LIMINA"**  
Fjalimi i benediktit XVI drejtuar geshkuvëve  
Nga: (Shtet: DON AVTON UKAJ)

**KREZMI rritje dhe rilindje në Shqipëri dhe**  
Nga: (Shtet: DON AVTON UKAJ)

**VËSHTRIM**  
KARL POPPERI figurë komplekse e filozofisë moderne (II)  
Nga: (Shtet: SAKS GJERQI)

## TË RINJTË I KEMI NË ZEMËR

**Shqiptarët katolikë në dhe marrëveshjet diplomatike - Konkordatet - Në Vatikanin me ju-Vaslavinë (II)**  
Nga: (Shtet: ZEF ANHUTI)

**Intervista me Jezusin e Nazaretit**

**Shejpt do të vij!**  
Nga: (Shtet: ZEF ANHUTI)